



Datës-Izlazn

Nr. 11-122

Data 12.02.2019

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Datë/Data/Date	11/02/2019
Nga/Od/From:	Kryetarini Komunës së Obiliqit z. Xhafer Gashi
Për/Za/To:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal z. Burim Gërguri
Tema/Subjekat/Subject:	Raporti i Punës për vitin 2018



I nderuar,

Ju lutem pranoni Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës, Drejtorive, Zyrës së Personelit, Zyrës Ligjore si dhe Zyrës për Komunitete dhe Kthim për vitin 2018.

Me respekt,



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare nr.28 te dt.04.06.2008), nenit 73 të Statutit të Komunës, neni 72 pika 1.7 e statutit të Komunës së Obiliqit Nr. I-34 të datës 25.04.2016 Kryetari i komunës raportonë për punët e përfunduara gjat vitit 2018.

RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2018

Obiliq, 2019

RAPORTI VJETORË I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS2
DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME4
DREJTORIA E SHËNDETËSIS DHE MIRËQENIES SOCIALE6
DREJTORIA E ARSIMIT20
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS26
DREJTORIA E URBANIZMIT28
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE MJEDIS.....	.41
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCA44
DREJTORIA E INSPEKSIONIT50
DREJTORIA PËR KULTURË RINI DHE SPORTË56
DREJTORIA E BUJQËSIS DHE ZHVILLIMIT RURAL57
ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM62
ZYRA E PERSONELIT65
ZYRA LIGJORE67
DREJTORIA E FINANCAVE00
PROKURIMI00

RAPORTI VJETORË I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS

• Raporti i Punës për vitin 2018

Të nderuar deputet të Kuvendit Komunal, fillimi i vitit 2018 është shoqëruar me sfida dhe vendime të cilat pritet në të ardhmen e afërt të ndryshojnë rrënjësisht pamjen e qytetit tonë. Duke parë rrjedhën e procesit zgjedhorë dhe besimin e marrë nga një numër i madh i qytetarëve të Komunës në mënyrë që të udhëheq dhe shtyjë përpara projektet në interes të qytetarëve dhe Komunës, ndihem i privilegjuar dhe jemi duke punuar me përkushtim maksimal për të realizuar projekte me rëndësi të veçantë për komunën e Obiliqit.

Gjatë kësaj periudhe kohorë kam mbajtur takime të rëndësishme me nivelin qendrorë, duke filluar nga Kryeministri z. Ramush Haradinaj, Ministri i Zhvillimit Ekonomik z. Valdrin Lliku, Ministrin e Mbrojtjes dhe Ambijentit znj. Albena Reshitaj, Ministrin e Shëndetësis z. Uran Ismaili, Ministrin e Punëve të Brendshme z. Bejtush Gashi, Ministrin e Zhvillimit Rajonal z. Rasim Demiri, Ministrinë për Kultur Rini dhe Sport z. Kujtim Gashi, Deputetë të Parlamentit të Kosovës dhe me shumë komponentë tjerë politik për të vazhduar bashkëpunimin me interes për komunën e Obiliqit. Gjatë gjithë këtyre takimeve kam kërkuar edhe nga Kryeministri, Ministrat dhe Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbështesin implementimin e Ligjit për Obiliqin, i cili tani është implementuar dhe Komuna e Obiliqit ka pasurë një rritje të madhe të buxhetit fal këtij Ligji.

Nëse e shikojmë dinamikën dhe planifikimin për vitin 2018 përkundër ndërrimit të objektit të Komunës, mund të themi se janë bërë disa punë të mirë dhe njëkohësisht kemi organizuar takime të rëndësishme me qytetarët dhe grupet e interesit brenda dhe jashtë komunës tonë, për të shikuar mundësin e rrugëtimit të përbashkët në projektet që kemi realizuar në vitin 2018 dhe projektet që planifikojmë ti realizojmë gjatë në tre vitet e ardhshme. Njëkohësisht kemi pasur takime në lidhje me projektin e ndërtimit të TERMOCENTRALIT KOSOVA E RE që pritet të ndodhë në komunën e Obiliqit, ku së fundi jemi duke bashkëpunuar me CounterGlobal dhe zhvillimet e ardhshme pritet të jenë në koordinim me Qeverinë – Komunën dhe kompaninë. Në lidhje me ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re kemi pritarë në takim Përfaqësuesen e Ambasadës Amerikane znj. Meredith Rubin dhe përfaqësuesin e USAI-it z. Eëlliam Trigg, të cilët na kanë siguruar se do të trajtohem si palë në implementimin e projektit i cili do të jetë me interes ë veçantë për qytetarët dhe banorët e Komunës së Obiliqit.

Projekte e realizuara dhe marrëveshjet e rëndësishme që i kemi filluar dhe përfunduar gjatë vitit 2018 janë:

- Puna më madhore gjatë vitit 2018, ishte implementimi i Ligjit për Obiliqin dhe më pas ndarja e vijës buxhetore e cila ishte një ndër arritjet më të mëdha të Komunës së Obiliqit në 20 vitet e fundit. Tani buxheti i komunës është rritur dhe kësaj për vitin 2019 kemi plus 4.972,124 mil. Euro më shumë, falë implementimit të Ligjit për Obiliqin.
- Gjatë këtij viti është finalizuar i objekti i Komunës së re dhe tani si Kryetar i komunës ndjehem i lehtësuare pasi që jemi në objektin e ri, ku edhe kushte për të qenë efikas në punë dhe në shërbim të qytetarëve janë shumë më të mira.
- Përfundimi dhe funksionalizimi i Objektit të qendrës së regjistrimit civilë.
- Nënshkrimi i memorandum bashkëpunimi me Ministrin e Infrastrukturës për realizimin e projekteve infrastrukturore në vlerë mbi 3 milion e 300 mijë euro.

- Nënshkrimi i marrëveshjes me Federatën e Futbollit të Kosovës për investime në stadiumi e qytetit "Agron Rama", ku vlera e investimit është rreth 3 milion euro.
- Nënshkrimi i marrëveshjes mirëkuptimi me Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Rasim Demiri, për financimin e projektit infrastrukturor ndërtimi i Trotuarit Obiliq-Milloshëvë. Projekt ky i përfunduar.
- Nënshkrimi i marrëveshjes mirëkuptimi me zv.Ministrin e MAPL-së z.Beqir Fejzullahu për financimin e projektit infrastrukturor asfaltimin e rrugës " Nuhi Kelmendi " në Obiliq. Projekt ky i përfunduar.
- Nënshkrimi i Memorandum mirëkuptimit me përfaqësuesin e GIZ-it Gjerman z. Kai Hofmann, për menaxhimin e mbeturinave.
- Takim dhe fillim i bashkpunimit me Kryeshefin Ekzekutiv të Hekurudhave të Kosovës z. Agron Thaçi, ku pritet të filloj projekti për rehabilitimin dhe funksionalizimin e linjës Hekurudhës në territorin e komunës së Obiliqit.
- Ndërtimi QKMF-së në Milloshevë – Projekt i realizuar dhe i cili tani është në shërbim të qytetarëve
- Nadarja e Parcellës për ndërtimin e Shkollës dhe Qerdhesë në Mazgit, investim ky i fituar si grand nga Bashkimin Evropian.
- Fitimi i çmimit në Garën për Mjedis e organizuar nga MMPH dhe GIZ-ë, ku ne si Komunë kemi përfituar njëçmimë në vler prej 60,000€, për performancë dhe Progres të arritur në Pastrimin e Ambientit dhe eliminimin e Deponive.
- Nënshkrimi i Memorandumit dhe fillimi i ndërtimit të Sheshi të Qytetit – Projekt që pritet të përfundoj gjatë vitit 2019
- Arritja e marrëveshjes me ndërrmarrjen hidroekonomike "Ibër - Lepenc" për Zonën Industriale, marrëveshje kjo e cila mundëson zhvillimin ekonomikë dhe krijimin e një zone biznesore
- Nënshkrimi i marrëveshjes me OSCE-në dhe Ministrinë e Drejtësis për parandalimin e dhunës në familje
- Fillimi i Parkut të qytetit në Obiliqin e vjetër
- Renovimi dhe funksionalizimi i AMF-së në fshatin Sibovcë
- Ndërtimi i Fushave të e sportit në Milloshev – Dardhishtë dhe në Shkollën Ibrahim Rugavo në Obiliq
- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Ambasadën Franceze për menaxhimin e resurseve ujorë me theksë të veqantë lumin Sitnica
- Fillimi i shtrirjes së Kanalizimit në fshatin Breznicë dhe Kozaricë, Projekt ky i financuarë nga MMPH-ja dhe që pritet të përfundj gjate këtij vitit.
- Komuna edhe në vitin 2018 ka fituar grandin e performances (për vitin 217) në vler prej 74,354 €, fal angazhimit dhe punës.
- Përfitimi i grandit 100,000 € nga MMPH-ja, duke dalurë një ndër komunat më të suksesshme në aksionin (Ta Pastrojmë Kosovën) e organizuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Gjat vitit 2018 Komuna e Obiliqit ka mbyllur përmbi 36 Deponi ilegale.
- Projektimi dhe fillimi i punëve në Parku e Mazgit, Parku te Obiliqi i vjetër, projekte këto që pritet të përmbillen gjatë këti viti.

DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Raporti i Punës për vitin 2018

Drejtoria e administratës në kuadër të kompetencave të saj, ka kryer punët administrative jo vetëm në shërbim të organeve të tjera të administratës, por edhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët e komunës së Obiliqit.

• Sektori i Administratës së Përgjithshme

Sektori i administratës së përgjithshme kryen të gjitha punët profesionale, juridike të Kuvendit dhe Komiteteve obligative dhe mbikëqyrë punët në QSHQ.

- Ky sektor përgatit të gjitha vendimet sipas kërkesës së prokurimit dhe njësive kërkuese.
- Përgjigjja në të gjitha kërkesat e qytetarëve drejtuar kryetarit, bordit të drejtorëve, po ashtu kemi bërë lëshimin e vërtetimeve për qëndrim në Kosovë për qytetarët e diasporës, gjithsejtë janë lëshuar 45 vërtetime.
- Kuvendi Komunal ka mbajtur (14) seanca, Komitetit për Politik dhe Financa (10) seanca, --
- Komitetit për Komunitete (9) seanca dhe i ka aprovuar (6) Rregullore.
- Këshilli Komunal për Siguri dhe Bashkësi (KKSB) ka mbajtur (6) mbledhje.
- Komuna e Obiliqit edhe ëtë vitë ka fituar Grandin e përformaces për vitin 2017 në shum prej 74,354 €.
- Gjatë periudhës raportuese kemi pasur (13) kërkesa për qasje në dokumentet publike të cilat janë aprovuara.
- Në këtë sektor bëhen përkthimi shqip-serbisht dhe anasjelltas i të gjitha materialeve për KK-se dhe komiteteve obligative , rregulloreve, vendimeve dhe materialeve tjera sipas kërkesës se drejtorive.
- Në këtë sektor bëhet Pranimi dhe evidenca e saktë për mallin e pranuar dhe për mallin e shpërndan si dhe futjen e të dhënave në friballanc, gjate vitit raportues kemi pasur (403) procedura për mallin e pranuar dhe te shpërndarë , ne shume prej 25,982.57 €

Njësia për të Drejtat e Njeriut

Ka mbajtur takime të rregullta me ABGJ (ZKM), divizionin për të drejtat e njeriut në MAPL, OJQ Aureola, organizatës Gratë për Gratë, pjesëmarrja në promovimin e aplikacionit për raportimin seksual "Ec shlirë", i lansuar nga rrjeti i grupit të grave, me KFOR-in, USAID-in, OSCE-në etj.

Vlenë të ceket se kemi pranuar ankesa nga komunitetit RAE, ku kane kërkuar ndihmë në regjistrim pranë ofiqarisë. Zyrtarët e kësaj njësie kanë marrë pjesë në shumë seminare lidhur me trajtimin e temave për të drejtat dhe barazia gjinore, në mbledhjet e KK-së dhe KKSB-së si dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme, projektin e 8 Marsit, Pjesëmarrja në punëtorin ditore njoftim rreth Dhomave të Specializuara nga udhëheqja e zyrës së Pjesëmarrjes së viktimave të luftës,punëtori kjo e organizuar nga Rrjeti i Grupit të Grave.

Gjatë këtij viti janë raportuar (12) raste të dhunës në familje të gjinisë F, njëra nga këto është sistemuar ne strehimore në Prishtinë.

Arkivi

- Zyra e arkivës (shkrimorja) e komunës mbahet në mënyrë elektronike-manuale, gjatë vitit 2018 janë proceduar (7.465) lëndë.
- Ekspeditivi i postës të lëndëve jashtë komunës-për institucione tjera përmes postës (238) lëndë.
- Zyrtari për saktësime i ka proceduar (339) lëndë te postes për institucionin e komunës dhe (419) saktësime.
- Zyra për Shërbime për qytetarët
- Punët e përditshme në pranim-dorëzimin e kërkesave të qytetarëve dhënia e informacioneve qytetarëve, ndihma dhe këshillat e nevojshme për realizimin e kërkesave dhe ankesave të tyre. Këto punë (lëndë) kryhen përmes intranetit dhe librave përkatëse, për periudhën raportuese, janë pranuar (33,865) lëndë, te miratuara (16,128) lëndë, te refuzuara (390) lëndë, në process(192) lëndë, te anuluar(98) lëndë, te hedhura poshtë – pezulluara (62) lëndë, ne proces (192) lëndë, te përfunduara (16,995).

Zyra e ofiqarisë

Në këtë zyre gjatë periudhës janar-dhjetor 2018, janë dorëzuar:

Ekstrakt lindjes	15,422
Certifikata të lindjes	4,270
Certifikata te martesës	3,253
Certifikata te vdekjes	833
Certifikata te vendbanimit	563
Certifikata e bashkësisë familjare	2,601
Certifikata e gjendjes martesore	604
Certifikata e shtetësisë	126
Vërtetim nga arkiva	274
Gjithsejtë	27,946
Numri i qytetareve qe kane kaluar ne regjistrin qendror	1,144

Shefi i sektorit në bashkëpunim me anëtarët e komisionit dhe sektorin e administratës kanë bërë përgatitjen e aktvendimeve:

- Për korrigjimin - regjistrim LAV- (25) aktvendime,
- LAL: korrigjim Emri dhe mbiemri- (24) aktvendime,
- Regjistrim: LAL- (26) aktvendime,
- Ndërrim emri dhe mbiemri- (9) aktvendime,
- Anulim ne LAL- (3) aktvendime.

Zyrtari i IT

- Gjatë kësaj periudhë kemi kaluar nga Komuna e vjetër në Objektivin e ri ,kemi pasur shumë vështësi pasi qe kemi pasur problem me koleksione të internetit.
- Gjate kësaj periudhë në sektorin e IT janë bërë (130) formatizime, dhe (5000) intervenime tek institucionet komunale, si në shëndetësi, arsim dhe poashtu në shkollat e komunës janë bërë shumë punë tjera duke përfshirë krijimin në SIMBNJ (380) kyçje në sitëm dhe (250) qasje në HRM SYSTEM .

- Janë bërë ingjizimet e mbledhjeve të kuvendit si dhe transmetimi drejt- përderejta me teleprezencë në MAPL dhe është bërë kyçja në CMS.
- Në tërësi faqe postimi i Rregulloreve të cilat nuk kanë qenë të postuara në CMS dhe dizajnimi i ballinës dhe shumë ndryshime në CMS (Contact management System) dhe CSS .
- Aplikacionet komunale në të cilat bëhet Administrimi i tyre janë: Intranet, E-arkiva, E-pasuria, Simbnj, SMVP, Domenin Mun.Gov.irk.rks, CMS, Free Balancë Eëb Aplikacion, Sistemin e MPB për riadhesim, Softëerin për Përkthim donacion nga USAIDI, Menagjimin e të dhënave personale i caktuar nga ASHMDHP (MPB) gjithsej (12) raste.

DREJTORIA E SHËNDETËSIS DHE MIRËQENIES SOCIALE

Raporti i Punës për vitin 2018

Drejtorja e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale gjatë vitit 2018 në kuadër të përgjegjësisë së veta ka kryer këto punë dhe detyra.

Janë kryer punët e përditëshme tekniko- administrative:

Takim me Ministrin dhe Sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë është biseduar për gjendjen në Kujdesin Parësor Shëndetësor dhe përmirësimin e këtij shërbimi të rëndësishëm si dhe rishikimi i listës esenciale të barënameve, furnizimi më i mirë me barëra dhe material shpenzues si dhe me insulinë për këtë sektor e që është kompetencë e Ministrisë së shëndetësisë.

Me organizatën Accessible Quality Healthcare (Kujdesi Shëndetësor i qasëshum dhe cilësor) kemi vazhduar me projektin i cili është projekt katër vjeçar dhe ky vitë është viti i tretë i bashkëpunimit, ku ne si Komunitet jemi në mesin e dymbëdhjetë Komunave të përzgjedhura nga kjo OJQ. Ky projekt implementohet nga Seiss TPH and Save the Children dhe përfitimet nga ky bashkëpunim janë të shumfajshme si: ngritja e kapaciteteve njerëzore në ofrimin e shërbimit cilësor shëndetësor, rregullimi i dhomës për konsultime shëndetësore për tema të ndryshme si Diabeti, sëmundjet kardiovaskulare etj. Po ashtu paisja me aparatura dhe paisje mjekësore të domosdoshme për këtë qëllim si dhe rregullimi i dhomës së triazhimit të pacientëve, kartotekës dhe një ordinacë me vlerë 70.000€.

- Me këtë organizatë jemi duke punuar në hartimin e strategjisë për kujdesin parësor shëndetësor për pesë vitet e ardhshme në vijim me mundësi rivlerësimi pas tri viteve, kjo strategji duhet të hartohet dhe të procedohet sipas procedurave për miratim në Kuvendin Komunal deri në muajin qershor të vitit 2019.

- Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale edhe është duke udhëhequr komisionin komunal për hartimin e programit tre vjeçar të banimit i cili duhet të hartohet dhe procedohet në Kuvendin Komunal për aprovim deri në muajin mars të vitit 2019.

- Kontakte me organizata tjera qeveritare dhe joqeveritare që merren me qështjet shëndetësore me UNICEFIN vazhdojmë me vizitat shtëpiake për shtatëzëna dhe fëmijë deri në tre vjeç, tri vizita gjatë shtatëzënisë dhe katër vizita për fëmijë.

- Organizimi i ligjëratës me temën kanceri i gjirit në kuadër të muajit fushata për sëmundjen e kancerit të gjirit.

- Me Kolegjin e drejtorëve të SHMS të Asociacionit të Komunave kemi zhvilluar disa takime për qështjet e shëndetësisë dhe të mirëqenies sociale sidomos për grantin specifik për shërbime sociale edhe

familjare, punëtori për ligjin e pagave, me sindikatën e shëndetësisë janë mbajtur katër punëtori me temën për dialogun social ku kontributi i drejtorisë tone ka qenë majft i çmuar.

-Gjatë vitit 2018 në QKMF janë realizuar këto projekte kapitale:

Me OJQ "Qëndresa Kosovare" me mbështetje financiare nga Ambasada e Jashtme e Kuvajtit është ndërtuar QMF-ja e re në Milloshevë në sipërfaqe prej (306) m², ndërtimi i të cilës ka pëfunduar në muajin shtator dhe pas furnizimit me inventar dhe pajisje mjekësore nga drejtorie e shëndetësisë, tash banorët e Milloshevës dhe fshatrave për rrethë marrin shërbim shëndetësor më cilësor. Ky projekt ka kushtuar (98,000) € nga donatori, si dhe drejtoria për inventar dhe pajisje mjekësore janë investuar (15,000) €.

- Renovimi i QKMF-së, AMF në Sibovc, AMF në Breznicë, QPS-së në në vlerë: (20,000) €
- Inventar për QKMF-QMF në Milloshevë (10,000) €
- Pajisje mjekësore për QKMF në vlerë: (18,000) €

DSHMS gjatë këtij viti ka bërë furnizime dhe shërbime tjera për nevojat e QKMF-së, QPS-së dhe Shtëpisë së pleqëve me këto furnizime si më poshtë:

1. Furnizim me karburant për ngrohje (QPS) (955.60) €

Raport me Furnizime për vitin 2018 në QKMF- Obiliq

	Furnizimi Nga DSHMS-KK- Obiliq				Total
	Ampullar	Laboratorik	Stomatologjik	Radio-Gjinekologjik	
Janar	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Shkurt	2,499.00 €	2,499.00 €	2,496.00 €	499.40 €	
Mars	1,356.20 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Prill	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Maj	0.00 €	3,494.20 €	0.00 €	0.00 €	
Qershor	45.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Korrik	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Gusht	3,100.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Shtatot	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Tetor	0.00 €	599.75 €	399.00 €	0.00 €	
Nentor	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Dhjetor	1,499.95 €	1,499.00 €	299.00 €	0.00 €	
Totali	8,500.15 €	8,091.95 €	3,194.00 €	499.40 €	20,285.50 €
	Materjali Admini. Sh	Materjali Higjenik	Materjali Administrativ		
Janar	0.00 €	0.00 €	0.00 €		
Shkurt	0.00 €	0.00 €	0.00 €		
Mars	544.50 €	0.00 €	0.00 €		
Prill	614.00 €	0.00 €	0.00 €		
Maj	0.00 €	0.00 €	0.00 €		
Qershor	0.00 €	0.00 €	0.00 €		
Korrik	0.00 €	0.00 €	0.00 €		
Gusht	0.00 €	0.00 €	0.00 €		

Shtatot	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Tetor	321.80 €	0.00 €	1,264.00 €	
Nentor	0.00 €	0.00 €	0.00 €	
Dhjetor	699.00 €	499.85 €	0.00 €	Total
Totali	2,179.30 €	499.85 €	1,264.00 €	3,943.15 €
	Inventar	Paisje Mjekësore	Uniforma	Deratizimi
Janar	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Shkurt	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Mars	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Prill	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Maj	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Qershor	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Korrik	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Gusht	0.00 €	0.00 €	4,937.00 €	0.00 €
Shtatot	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Tetor	7,605.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Nentor	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €
Dhjetor	0.00 €	11,159.50 €	0.00 €	927.95 €
Totali	7,605.00 €	11,159.50 €	4,937.00 €	927.95 €
				Total
				24,629.45 €

	Furnizimet nga Ministria Shëndetsisë
Janar	5,106.06 €
Shkurt	3,415.99 €
Mars	5,072.19 €
Prill	5,232.82 €
Maj	4,630.24 €
Qershor	5,965.41 €
Korrik	7,747.31 €
Gusht	7,858.15 €
Shtatot	7,037.25 €
Tetor	6,641.99 €
Nentor	7,996.65 €
Dhjetor	15,093.70 €
Totali	81,797.74 €

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Gjatë kësaj kohe Këshilli Drejtues i QKMF-së ka vazhduar me takimet ditore rreth rrjedhës së punës, marrjen e të gjitha masave për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, disiplinës, orarit të punës etj. Në QKMF gjatë kësaj periudhe kohore janë trajtuar një numër i madh i pacientëve dhe janë ofruar një numër i konsiderueshëm i shërbimeve (shih tabelën):

NUMRI I PACIENTËVE DHE NUMRI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

Nr	QENDRA KRYESORE E MJEKËSIS FAMILJARE	Numri i vizitave mjekësore	Numri i shërbimeve mjekësore	Totali vizita + shërbime
1.	QKMF OBILIQ	83080	104383	187463
2.	QMF MILLOSHEVË	4217	9736	13953
3.	QMF PLEMETIN	4697	3302	7999
4.	AMF SIBOVC	2059	5915	7974
5.	AMF BREZNICË	2370	6423	8793
6.	AMF B.MOFC	1726	7053	8779
	TOTALI	98149	136812	234961

REFERIMET

ANAR - DHJETOR 2018

KMF -Obiliq		Nr. i referimeve PËR KONSULTI MENË kujdesin dytësorë	Nr. i referimeve NË DIAGNOSTIK EN e kujdesit dytësorë	Gjithsej Udhëzime për Kujdesin dytësorë	Numri i përgjithshëm i vizitave mjekësore	Përqindja (%) e të referuarve në kujdesin dytësorë
Spëcialiteti	Departmenti					
KMF Obiliq	Mjekësi Familjare	5205	77	5282	35040	15%
QKMF Obiliq	Emergjenca	656	334	990	14881	6.5%
KMF Obiliq	Pediatria	1526	211	1737	11874	14.6%
KMF Obiliq	Gjinekologjia	19	66	85	676	12.5%
KMF Obiliq	Shëndeti oral	143	226	369	3984	9.2%
MF illoshevë	Mjekësi Familjare	961	115	1076	3977	27%
MF illoshevë	Shëndeti Oral	11	8	19	308	6.1%
MF Plemetin	Mjekësi familjare	4	10	14	4697	0.29%
MF Breznicë	Mjekësi Familjare	391	26	417	2370	17.5%
MF Siboc	Mjekësi Familjare	226	63	289	2059	14%
MF.B.Mofc	Mjekësi familjare	409	92	501	1801	27.8%
MF Palaj	Mjekësi Familjare	0	0	0	0	0%
MF-hipitullë	Mjekësi Familjare	0	0	0	0	0%

9551	1228	10779	81667	13.19%
------	------	-------	-------	--------

Ne tabelën e më poshtme janë të dhënat për Sëmundjet masive jo infektive për periudhën Janar – Dhjetor 2018

Të sëmundjeve masive joinfektive,

1. F00,F04,F05 ,F09,F20,F30,F31,F32.3,F33,F22,F29,F84, G71 (shëndetit mental)
2. E10-E14,(sëmundjes së sheqerit)
3. I00-.I02, I20,I21,I24,I25(sëmundjeve kardiovaskulare)
4. N05(nefropatit)N03,N04,N05,N10,N18
5. J42,J45,J47 ,(sistemit respirator)
6. D65-D69,C-(sëmundje malinje)

Sëmundjet	Numri
I10	498
I20, I21, I24, I25	9
E10-E14	127
J42, J45, J47	27
N03, N04, N05, N10, N18	5
F00-F48	9
Sëmundjet malinje	29
Numri i refrimeve në nivelin sekondar	9551
Numri i referimeve në diagnostikë	1228
Totali i pacientëve	81667

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA NË QKMF- DEPARTAMENTI I MJEKËSISË FAMILJARE

SEKTORI I MJEKËSIS FAMILJARE		
1.	Numri i pacientëve të vizituar	34950
	Totali i shërbimeve	29356

SEKTORI KONSULTATIV

NJËSIA E PEDIATRISË		
1.	Numri i pacientëve të vizituar	11804
	Totali i shërbimeve	3383

NJËSIA E GJINEKOLOGJISË		
-------------------------	--	--

1.	Numri i pacientëve	676
	Totali i shërbimeve	1412

SEKTORI I SHËNDETIT PUBLIK

	NJËSIA E SISH-IT	
1.	Numri i pacientëve të regjistruar	50816

	NJËSIA E VAKSINIMIT DHE IMUNIZIMIT	
1.	Numri i shërbimeve	11299

SEKTORI I KUJDESIT EMERGJENT

	KUJDESI EMERGJENT	
	Numri i Pacientëve	14881
	Totali i shërbimeve	17729

SEKTORI I SHËNDETIT ORAL

	SHËNDETI ORAL	
	Numri i Pacientëve	3984
	Totali i shërbimeve	8516

SEKTORI I DIAGNOSTIKËS

	LABORATORI	
	Totali i analizave të punuara	14870

	RTG	
	Totali i shërbimeve	4443

	BARNATORJA NË QKMF		
	TOTALI I SHËRBIMEVE	12699	Pacienta 8456 Receta 12699

	VIZITAT SHTËPIAKE PËR NËNËN DHE FËMIUN DERI NË TRI VJET	
1.	Nr. i vizitave në shtëpi	344

	KËSHILLIMORJA PËR PERSONAT ME DIABET DHE HIPERTENSION	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	619
2.	Totali i shërbimeve	1479

MJEKËSIA FAMILJARE NË TEREN

	QMF MILLOSHEVË	
1.	Numri i pacientëve të vizituar	4069
	Totali i shërbimeve	9694

	QMF PLEMETIN	Total pacienta
1.	Numri i pacientëve të vizituar	4706
	Totali i shërbimeve	3302

	AMF SIBOVC	Total pacienta
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2059
	Totali i shërbimeve	5915

	AMF BREZNICË	Total pacienta
1.	Numri i pacientëve të vizituar	2369
	Totali i shërbimeve	6611

10

	AMF B.MOVC	Total pacienta
1.	Numri i pacientëve të vizituar	1726
	Totali i shërbimeve	7053

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i administratës këtë periudhë ka funksionuar pa ngecje. Në vazhdimësi është raportuar në baza ditore, javore, mujore, si dhe është mbajtur evidenca rreth vijimit të punëtorëve. Organizimi i pushimeve vjetore, përpilimi i listave të kujdestarive në vazhdimësi janë përpiluar nga Kryeshefi i Dep të MF, Shefi i Administratës në bashkëveprim me Kryeinfermierën.

TË HYRAT NGA PARTICIPIMI

Data e dorëzimit Janar - Dhjetor	Shuma	Vendi ku janë dorrëzuar
TOTALI	21721.6 E	NLB

RAPORT I KARBURANTEVE

	Benzin	Dizell		
1-12/2018		7891.77 litra		

Njësia për shërbime teknike

Sa i përket furnizimit me material higjienik ka qenë i kënaqëshëm. Higjiena ka qenë deri diku në nivel të duhur-me vërejtje të kohë – pasë - kohëshme për asye të renovimeve.

Barnatorja qendrore

Furnizimi me barëra brenda kësaj periudhe nuk ka qenë e kënaqëshme. Kemi pasë mungese të madhe me barna nga lista esenciale e barnave. Barërat që kanë arritur në barnatore janë shpërndar vazhdimisht nëpër QMF-ë dhe AMF-ë. Kërkesat për barëra nga lista esenciale janë dorrëzuar në Korporatë me rregullë. Po ashtu vlenë të përmendet se furnizimi me insulinë ka qenë në nivel të kënaqëshëm.

ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (ZHVP)

Në QKMF-ë në kuadër të ZHVP-së u mbajtën këto ligjerata për Mjek dhe Infermier:

Për Mjekë: (8) ligjerata.

Për Infermier: (10) ligjerata.

Jashtë QKMF-së:

- Gjithsej gjatë kësaj periudhe u trajnuan:
(49) Mjek në tema të ndryshme që kanë rëndësi në ngritjen e shkathtësive profesionale

- Gjithsej gjatë kësaj periudhe u trajnuan:

41 Infermier në tema të ndryshme që kanë rëndësi në ngritje e shkathtësive profesionale
Puna në Komunitet

Në kuadër të aktiviteteve të KOPF-së dhe AQH-së janë mbajtur këto aktivitete në komunitet në komunën e Obiliqit:

- Me datën 18/01/2018 ne fshatin Mazgit është mbajtur një ligjeratë me temën: Diabeti
- Me datën 26/01/2018 në fshatin Dardhishtë në objektin e shkollës së mesme të ultë dhe në SH.M.U Pandeli Sotiri është mbajtur ligjerata me temën Diabeti.
- Me datën 30/01/2018 ne SH.M.U në Plemetin me popullatën REA është mbajtur ligjeratë me temën Diabeti nga Dr. Rejhane Zhushi, organizuar nga organizata Health me (25) pjesëmarrës të komuniteteit REA.

- **Me datën 08/02/2018** u shënuar Dita botërore e kancerit me ku ligjëruese ishte Dr. Vjollca Hoti, për nxënësit e kësaj shkolle me temën “Sëmundjet malinje të qafës së mitrës” në -shkollën e mesme teknike
- **Me 28/03/2018** në Plemetin në Komunitet REA u mbajtën dy ligjerata me temat “Diabeti” dhe “Hipertensioni arterial” nga Dr. Rejhane Zhushi, organizuar nga OJQ “Health for all”.
- **Me 29/03/2018** në Plemetin në Komunitet REA u mbajtën një ligjeratë me temën “Hipertensioni arterial” nga Dr. Rejhane Zhushi, organizuar nga OJQ “Health for all”.

Vizita Sistematike në Sh.F.M.U. Obiliq

- Në QKMF edhe këtë vit është realizuar projektin e vizitave sistematike për nxënësit e Shkollave Filllore të Mesme të Ulta në Komunën e Obiliqit.
- Për këtë vit u planifikua që vizitat sistematike të përfshijnë nxënësit e klasave të I, IV, VIII.
- Edhe këtë vit metodologjia e punës ishte e njëjtë me ato të viteve paraprake. Të gjitha të dhënat e vizitave sistematike u evidentuan në kartelat shëndetësore të çdo nxënësi.

Qëllimi i këtyre vizitave sistematike është vlerësimi i rritjes dhe zhvillimit psiko-fizikë i fëmijëve të këtyre grup moshave, zbulimi hershëm i sëmundjeve, anomalive dhe çrregullimeve eventuale si dhe prevenimi me kohë, korigjimi i anomalive dhe trajtimi i sëmundjeve.

Në këto vizita janë përfshirë në ekzaminim këto parametra psh: dhe gjatësia trupore, kontrolli i të pamurit, dëgjuarit, kontrolli detal: i lëkurës, kokës, hundës, gojës, dhëmbëve, gjëndrrës tiroide, gjëndrat limfatike, zembrës, mushkërit, barkut, ekstremitetet, boshtit kurrizor, gjoksit si dhe të metat në të folur.

Për realizimin e këtij aktiviteti u angazhuan (2) ekipe implementuese. Ekipi kishte: një Mjek Familjar, një Epidemiolog, (4) Infermiere të Mjekësis Familjare, dy Stomatolog dhe një Asistente e stomatologjisë. Gjithësejt personel të angazhuar për vizita sistematike ishin (9). Plani i punës dhe orari i implementimit të këtij aktiviteti është hartuar në bazë të numrit të shkollave dhe numrit të nxënësve.

Vizitat sistematike në SHMU të Komunës së Obiliq-it u realizuan nga data 07/05/2018 deri më 31/05/2018
Numri i nxënësve të përfshirë në vizita: (922) nxënës

Numri i klasëve: (51) klasë

Numri i nxënësve të trajtuar dhe udhëzuar në kujdes dytësor: (124)

Dita botërore e zembrës 29 Shtatori, u shënuar në QKMF Obiliq me 28/09/2018. Me këtë rast ekipi për ESH iu mati TA dhe shpërndau lifletat “Zemra ime, Zemra juaj” pacientëve të rastit.

Me datë 12/10/2018 KK Obiliq, DSHMS dhe Dr.Vjollca Hoti Koordinator i KESH-it, organizoi shënimin e ditës ndërkombëtare të “Kancerit të gjirit”, me këtë rast Shoqata e Onkologëve të Kosovës në bashkëveprim me OJQ-në “Jeta vita” iu bashkangjit këti shënim dhe Dr. Arta Kamberi-Jusufo Onkologe-Radioterapute mbajti ligjeratën Kanceri i gjirit. Ishin të pranishëm edhe IKSHPK-ja.

Me datë 26/10/2018 Dr.Vjollca Hoti mbajti ligjeratë në Plemetin me temën “Kanceri i gjirit”, me c’rast rreth (25) gra të komunitetit morën pjesë, ku ishte e pranishme edhe OJQ “Balcan sun floëer”.

Me datën 19/10/2018 në Plemetin me komunitetin rom,ashkali,egjiptas janë mbajtur (2) ligjerata me teme:Diabeti si dhe me datën 20/10/2018 me temën Hipertensioni arterial, e organizuar nga organizata joqeveritare Health For All e mbështetur nga organizata AQH me ligjerues,Dr.Rejhane Zhushi-Musliu.

Me datën 24/10/2018 në Millosheve me komunitetin ashkali janë mbajtur (2) ligjerata me temën e diabetit dhe hipertensionit arterial e organizuar nga organizata joqeveritare Health For All e mbështetur nga AQH. me ligjerues, Dr. Rejhane Zhushi-Musliu

Me datën 25/10/2018 me banoret në Breznice në objektin e shkolles është mbajtur ligjerate me temën: Diabeti, e organizuar nga organizata joqeveritare KOPF e mbështetur nga AQH-ë me ligjerues, Dr. Rejhane Zhushi-Musliu

Me datën 26/10/2018, shërbimin e vaksinimit e viziton drejtoresha e organizatës EDUCATION CODE dhe na njofton se në nëntor duhet të implementojmë projektin Vaksinimi dhe ruajtja e shëndetit për komunitetin REA, projekt i mbështetur nga ministria e shëndetësisë për komunën e Obiliqit.

Takime:

Gjatë vitit u realizuan takime të shumta me donatorë:

Të gjitha kontaktet për donacione dhe bashkëpunim janë bërë në bashkëveprim me Kryetarin e Komunës, DSHMS-në dhe Këshillin Drejtues të QKMF-së.

- Takime me OJQ-në Caritas.
- Takim me Spitalin Amerikan rreth Trajnimit të stafit të urgjencës.
- Takim me Qendrën Emergjente në QKUK rreth trajnimit të stafit të urgjencës. Me këtë rast dy Infermier vijuan trajnimin tre mujor në Qendrën Emergjente
- OJQ "Qëndresa Kosovare" – takim rreth investimeve.
- Me 08/03/2018 OJQ "AQH" solli në QKMF dy Glicometra jo invaziv dhe trajnoi tre Mjek dhe infermier.
- Në muajin Prill filluan punën (7) punëtor të rinj, përmes projektit, projekt ky i KK Obiliq në partneritet me OJQ-në Caritas, (3) mjek, (3) Infermier dhe një vozitës.
- Gjatë vitit u realizuan disa takime me Shoqatën Bamirëse Kuvaitiane për të rishqyrtuar mundësit për ndonjë donacion eventuale.
- Vazhduan takimet me Fondacionin e Katarit ku është dorëzua kërkesa për paisje mjekësore, objektin e ri për QKMF. Po ashtu takime të rregullta me Fondacionin e Kuvajtit dhe OJQ-në "Qëndresa Kosovare" janë mbajtur lidhur me donacionet e mundshme.
- Vazhduan takimet dhe kërkesat me donatorët tjerë të mundshëm nga vendet përendimore, në muajin Nëntor

Sukseset, sfidat dhe vështërsit me të cilat jemi ballafaquar gjatë këtij viti:

- Me 29/09/2018 është bërë përrurimi i objektit të ri QMF Milloshevë, ndërtimi i të cilit filloi me 16/04/2018 me një hapsirë prej 324m² në bashkëveprim me Kryetarin e Komunës.
- Kuvendin Komunal, Drejtorin e DSHMS dhe donacionin nga OJQ "Qëndresa Kosovare". Objekti është donacion nga OJQ "Qëndresa Kosovare", kurse është inventarizuar nga DSHMS.
- QMF-së Milloshevë me karrigë të re stomatologjike është paisur këtë vit.
- I gjithë personeli u paisën me uniforma punuese.
- Është përfundoj renovimi komplet i AMF Sibofc.
- Punimet në aneks objektin e QKMF-së, përfunduan.
- AQH, e cila është OJQ Zvicrane investoi në QKMF në vlerë prej 75,000€ gjatë këtij viti, po ashtu duhet përmendur ndërtimin e recepcionit në QKMF-së, projekt i AQH-së, që filloi në Shtator dhe vazhdon.
- Njësia e Gjinekologjisë, Stomatologjisë dhe Radiologjisë janë pajisur me mjete punuese të reja, të cilat ishin më se të domosdoshme.

Rekomandimet:

- Kërkojm nga DSHMS që nga lista jonë e pagave të largohen dy punëtorët e KK Obiliq dhe një i QPS-së

Skema e Ndhmës Sociale:

Skema e Ndhmës Sociale në Obiliq është ngritur në vitin 2000, ndërsa komplet me stafin Qendra ka filluar punën në shkurt të vitit 2002, dhe është një ndër format e mbrojtjes sociale në mënyrë që të lehtësohet varfëria me anë të ndihmave sociale për të varfërit dhe familjet në gjendje të nevojës sociale. Skema e Ndhmës Sociale është një mbështetje dhe ofrim i ndihmës së përkohshme financiare për familjet në varfëri. Kjo ndihmë e përkohshme financiare u ofrohet familjeve të cilat plotësojnë kriteret dhe kushtet e përcaktuar me Ligjin Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, Ligjin Nr.04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, një numri të caktuar të udhëzimeve administrative dhe në bazë të buxhetit vjetor që Qeveria e Republikës së Kosovës ndanë për këtë skemë.

Struktura organizative e Skemës së Ndhmave Sociale

Struktura e e Ndhmës Sociale është e organizuar në këto nivele:

- Niveli qendror: Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS)
- Divizioni i Ndhmave Sociale (DMS),

Niveli lokal:

- Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale (DSHMS)
- Qendra për Punë Sociale (QPS)

Shuma mujore e ndihmës sociale përcaktohet sipas numrit të antarëve të familjes dhe kostos së çmimeve të shportës së ushqimit, e cila rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria. Minimalja e ndihmës sociale është 50 € ndërsa maksimalja është 150 €.

Ofrimi i Ndhmës Sociale gjate periudhës 1 vjeqare per vitin 2018

Sipas kushteve dhe kriterëve që parashihen me aktet ligjore dhe nënligjore të Skemës së Ndhmave Sociale, Ndhimen Sociale për periudhën raportuese e kanë realizuar numri i familjeve si me poshtë:

Muaji	Nr.i familjeve ne SNS	Antaret e familjes ne SNS	Shuma ne €
Janar	902	3,702	97,925.00 €
Shkurt	857	3,536	92,942.50 €
Mars	805	3,320	82,758.75 €
Prill	795	3,277	86,395.00 €
Maj	809	3,331	88,362.50 €
Qershor	819	3,368	89,242.50 €
Korrik	808	3,342	87,720.00 €
Gusht	801	3,325	86,572.50 €
Shtator	796	3,283	86,217.50 €

Tetor	784	3,244	84,622.50 €
Nentor	787	3,255	86,315.00 €
Dhjetor			
Gjithesej:			885,450.25 €

Numri i familjeve në SNS është zvogëluar për shkak të rekomandimit nga NJKM. I kemi rivefikuar familjet në terren gjatë muajit janar - mars të vitit 2018.

Gjatë vitit 2018 kemi pasur këto: Aplikime, Riaplikime, Riaktivizime dhe Ndërprerje.

Muajt	Aplikime	Riaplikime	Riaktivizime	Ndërprerje
Janar	4	134	4	8
Shkurt	5	100	5	36
Mars	3	129	4	55
Prill	5	135	6	13
Maj	6	93	4	15
Qershor	4	77	1	7
Korrik	4	90	2	9
Gusht	2	60	0	4
Shtator	6	67	2	20
Tetor	4	75	2	18
Nentor	3	84	3	10
Dhjetor	4	103	1	12

Lendet e komisionit mjekësor

	Lendet e Aprovuara nga K.Mjekësor	Lendet e refuzuara nga K.Mjekësor	Gjithesej
Janar	59	2	61
Shkurt	30	5	35
Mars	47	2	49
Prill	32	2	34

Maj	54	2	56
Qershor	42	1	43
Korrik	30	0	30
Gusht	27	1	28
Shtator	28	7	35
Tetor	30	3	33
Nentor	40	2	42
Dhjetor	40	2	40

- Njësia e Kontrollit Monitorues ka verifikuar nga Skema e Ndhmës Sociale prej datës 25.01.2018 deri me datën 01.02.2018
- Nga rekomandimet e NJKM nga kontrollera e jashtëzakonshme kemi riverifikuar

870 familje, prej tyre janë larguar (112) të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret e SNS-se.

- Një donator ka shperndar (600) kg mill me daten 25.05.2018 gjate muajit Ramazan (12) familje me nga (50)kg miell.
- Gjate gjashte mujorit kemi patur (15) ankesa për shkallen e dyte ne DMS prej tyre (3) lënde pozitive dhe (2) ne ri-procedure.
- Me datën 07.06.2018 një donator ka shpernda pako me gjera ushqimore (4) familje ne vlere prej 50 €.
- Me datën 13.06.2018 Organizata SHHBK "Duart e bamiresise" ka shpernda miell nga 50 kg numri i familjeve skamnore ka qene 370. Shperndarja është bere nga punëtorët e QPS-se në bashkëpunim me organizatën e lartpërmendur.
- Me daten 10.07.2018 DMS-ja bashke me punetoret e QPS-se kemi shperndare veshmbathje , perfitus jane 150 familje me nevoje , ne Plemetine-Obiliq.
- Dy familje raste sociale jane bere me shtepi te reja nga Shoqata bamiresse "Jetimat e ballkanit" gjate muajit gusht te vitit 2018.E falenderojme shoqaten ne fjale bere bamiresin e tyre ndaj ketyre dy familjeve skamnore.
- Me daten 20.08.2018 Firma Business Pro(Creative business solutions) dhe Pro (Transport & Logistics) kane dhuru nga 50 €,4 pako ushqimore per 4 familje nga nje pako ne bashkepunim me QPS ne Obiliq.
- Nga Firma Ston Castel jane shpernda 50 pako ushqimore per nenat vetushqyese dhe nga 100 kg miell.
- Si dhe nga Shoqata Zero-pozitiv jane shperndar per (75) familje nga 4 jakne.
- Me daten 19.12.2018 nga dogana e Kosoves kemi shpernda per (20) familje pako ushqimore .
- Vertetima të leshuar nga QPS-ja gjate vitit 2018 jane (120) .

Shërbimet Sociale dhe Familjare

Gjatë muajit gusht 2018 në shërbimet sociale dhe familjare janë paraqitur gjithsej (385) raste. Dhe për këto raste janë ndërmarr gjithsej (752) aktivitete.

1.Fëmij pa kujdes prindor (12)

- 2.Kërkesa për strehim familjar (12)
- 3.Kërkesa për adoptim vendor (3)
- 4.Kërkesa për adoptim ndërkombëtar (1)
- 5.Fëmij I keqtrajtuar (2)
- 6.Fëmij me sjellje asociale (1)
- 7.Përdoruesit e substancave narkotike
- 8.Puna e rrezikshme (6)
- 9.Rrëmbim ndërkombëtar i fëmijëve
- 10.Të miturit në konflikt me ligjin (35)
- 11.Viktimat e dhunes në familje (8)
- 12.Viktimat e trafikimit
- 13.viktima e krimeve seksuale (1)
- 14.Martesa e të miturëve (2)
- 15.Kërkesë për këshilla martesore (27)
- 16.Të moshuarit (2)

Klient të tjerë :

- A. Me probleme familjare (9)
- B.Nënat vetëushqyese (6)
- C.Personat me aftësi të kufizuar (4)
- D.Fëmijë me aftësi të kufizuar (16)
- E.Aftësia e prindërve nuk është adekuate për përkujdesje ndaj fëmijës
- F/1. Vertetim për armëmbajtje (51)
- F/2. Vertetim për punësim (82)
- F/3. Vertetim për SNS (19)
- F/4. Vertetim për humbje të shtetësië (82)
- G.Nëna e cila potencialisht do të braktisë fëmijën e saj (1)
- H.Nëna e cila e ka braktisur fëmijën e saj
- I.Babai i cili ka braktise fëmijën e tij
- J.Regjistrimi i më vonshëm i fëmijëve (3)
- K. Arsyje tjetër (3)

Gjithashtu lidhur me ofrimin e Shërbimeve sociale janë ofruar (752) aktivitete të ndryshme të kategorive sociale si: vizita në shtëpi, intervista dhe bashkëpunim ndërinstitucional. Kemi pasur bashkëpunim të ndërsjellt me Organizata Qeveritare dhe jo Qeveritare, siq është OFAM-i , UNICEF-i, bashkëpunim me MPMS-në,Komunën , dhe Policinë e Kosovës etj.
Obiliq, dhjetor 2018.

DREJTORIA E ARSIMIT

Raporti i Punës për vitin 2018

Vizioni i DKA-së

Krijimi i ambientit adekuat në shkolla, i cili do të jetë i përshtatshëm për të gjithë, ku do të vie në shprehje mësimdhënia dhe mësimnxënia sipas të gjitha kriterëve avansuese të një shkolle moderne.

DKA, synon që këtë vizion ta realizoj përmes objektivave:

- Ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit
- Përmirësimi i kushteve teknike të infrastructures shkollore

Objectiva e parë, gjegjësisht ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit është objektivë e përhershme.

Ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit, do realizohet gjithnjë duke i zbatuar politikat arsimore të MASHT-it në nivel vendi, por edhe të atyre që dalin mbi organizimin e procesit edukativo-arsimor në nivelin komunal, për realizimin e kësaj objective do të ndërmerren këto veprime:

1. Ngritja e performancës së mësimdhënësve në aspektin e llogaridhënjës dhe angazhimit për realizimin e detyrave të punës.
2. Gjithëpërfshirja pa dallim në procesin edukativo- arsimor
3. Parandalimi i braktisjes
4. Organizimi i mësimi jo formal për të dy nivelet e shkollimit parauniversitare.

DKA vlerëson, se synimi parësor, ngritja e cilësisë është duke u realizuar me sukses, duke arritur rezultate të kalueshmërisë në vlerësimin e jashtëm, mbi mesataren në nivel të Republikës së Kosovës, që është një tregues i besueshëm për nivelin e cilësisë në të dy nivelet e shkollimit, atë të mesëm dhe fillor në komunën e Obiliqit.

Objectiva e dytë, gjegjësisht përmirësimi i kushteve teknike të infrastructures shkollore, është realizuar përmes tri projekteve kapitale:

1. Ndertimi dhe rregullimi i infrastructures shkollore
2. Renovimi i shkollave dhe blerja e paisjeve
3. Renovimi i infrastrukturës shkollore

Punët e realizuara nga projektet kapitale në DKA në vitin 2018

- SHFMU „Migjeni” Sibovc: Ndertimi i deposë për lendë djegëse (dru e thëngjill), ndertimi grilës mbrojtëse mbi lumin në hyrje të shkollës
- SHFMU „Migjeni” Grabovc: Ndërrimi i dritareve, renovimi i nyjeve sanitare.
- SHFMU „Abdurrahman Gërguri” Dardhishtë: Izolimi termik i pllakes së shkollës nën pullaz. renovimi I nyjeve sanitare.

- SHFMU „Ibrahim Rugova” Obiliq me paralelet e ndara: Renovimi i dyshemesë, ndërrimi I mbulesës së pullazit të kaldatorës, renovimi i oxhakut e kaldatorës, renovimi i sistemit të e kamerave, renovimi I nyjeve sanitare , duke përfshir edhe montimin e 28 m² të pllakave të keramikës në nyje sanitare në shkollën amë, montimi I tabelave me mbishkrim te emërit të shkollës në dy paralelet e ndara.
- SHFMU „Pandeli Sotiri” Obiliq me paralelën e ndarë në Plemetin: Renovimi i tubit shkarkues të tymit të kaldasë, ndërrimi I pompes qarkulluese të ujit në sistemin e nzemjës në Plemetin, ngjyrosja me ngjyrë yndyrore të pjesës bazë në Plemetin, blerja e paisjeve elektronike (printer 3në 1), renovimi i nyjeve sanitare, montimi I tabelave të mbishkrimit të shkollave.
- SHFMU „Hasan Prishtina” Milloshevë: Ngjyrosja e shkollës në pjesën e pasme të sajë, renovimi i trupave ndriques në oborrin e shkollës, ndërrimi i panelit ndriques në holin e shkollës, renovimi i nyjeve sanitare, dhe pllakave të dëmtuara në koridorin e shkollës.
- IP „Rrita Jonë” Obiliq: Renovimi i dyshemesë, renovimi i nyjeve sanitare, blerja e paisjeve, enalarësës, rrobalarses.
- SHFMU „Naim Frashëri” Breznicë: Ndërtimi i deposë për lëndë djegëse, renovimi I nyjeve sanitare.
- SHFMU „Fazli Grajqevci” Hade me paralelet e ndara, renovimi i nyjeve sanitare, blerja e paisjës së printerit (3në 1), ndërtimi i deposë për lëndë djegëse në Palaj, ndërtimi i rrethojës së fushës së sportit në Palaj (investim i UMNIK-ut).
- SHMLP „Ismail Dumoshi”: Ndërtimi i punëtorive dhe depove për lëndë djegëse, ndarja e tri klasave(lëvizja e mureve ekzistuese), ndërtimi I bazamentit të bustit „ Ismail Dumoshi”.
- Gjimnazi „17 Shkurti”: Ndarja e dy klasave (lëvizja e mureve ekzistuese), renovimi I nyjeve sanitare.

Angazhimet dhe aktivitet e zhvilluara:

- Kremtimi i Ditës së Mësuesit – 7 Marsi 2018
- Ndarja e Çmimit “Mësimdhënës i dalluar “ 2018
- Rishqyrtimi dhe procedimi për miratim në Asamble Komunale të Rregullorës për ndarjën e bursave dhe kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit, për nx. dhe student.
- Procedimi i kërkesës në Asamblenë Komunale, për kompenzimin e të gjitha obligimeve, sipas të gjitha kontratave kolektive, për ish të punuarit në arsim në komunën e Obiliqit e tani të pensionuar, dhe miratimi i sajë.
- Procedimi në Asamblenë Komunale, të kërkesave për aprovimin e lokacioneve për ndërtimin e shkollës dhe kopshtit për fëmijë, projekt i IPA II.
- Furnizimi i shkollave me material pedagogjik
- Ndarja e pjesës së dytë të bursave, për 50 studentë, dhe 23 nxënës.
- Shpallja e konkurseve për mësimdhënës dhe organizimi I intervistave
- Monitorimi I shetitjeve të organizuara për kl. e IX-ta
- Organizimi I ekskursioneve për maturant
- Monitorimi I hartimit të projekteve dhe paramasave për investime kapitale për këtë vit buxhetor

- Organizimi i Testit të Arritshmërisë 2018
- Pjesëmarrja në organizimin e Testit të Maturës Shtetërore 2018
- Përgatitja e planit buxhetor të DKA-së sipas formulës së financimit
- Shpallja e konkursit për regjistrimin e nx. në kl. e dhjetë.
- Monitorimi i regjistrimit të nx. në kl. e X-të.
- Përgatitjet e statistikave të suksesit për Asamblen Komunale dhe MASHT-in
- Publikimi i konkurseve për stafin drejtues dhe mësimdhënës për shkolla
- Trajtimi i konkurseve për stafin drejtues dhe mësimdhënës për shkolla.
- Monitorimi i realizimit të projekteve kapitale, të parapara për të gjitha drejtorit e Komunës së obiliqit, në cilësinë e antarit të taskforcës.
- Organizimi i Testit të Maturës për afatin e gushtit 2018.
- Përkaditjet e shkollave për fillimin e vitit shk. 2018/2019
- Publikimi I konkursit për kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit për nx.
- Publikimi I konkurseve për bursa, për studentët dhe për nxënës.
- Publikimi përfituesëve të kompenzimit të shpenzimeve të udhëtimit për nx.
- Publikimi I përfituesëve të bursave, për nxënsit dhe student
- Kompenzimi I pjesës së parë të kompenzimit të shpenzimeve të udhëtimit për nx.
- Kompenzimi i pjesës së parë të Bursave për vitin shk., përkatësisht akademik 2018/2019
- Pranimi në menagjim i projekteve kapitale të realizuara nëpër shkolla.

Rezultatet:

**Suksesi i tregur në procesin edukativo arsimor në fund të gjysëmvetorit të parë të vitit shkollor 2018/2019.
Arsimi fillor, niveli 1-5**

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv												Numri i mungesave							
			Shkëlqyeshëm			Sh. mirë			Mirë			Mjaftueshëm			Gjithsej me nota pozitive			Gjithsej me nota negative që përcillen	Të pa notuar	Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
			Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr					
1	20	372	276	74.19	63	16.94	23	6.18	10	2.69	372	100	0	0	0	0	0	0	1491	125	1616	
2	19	339	208	61.36	68	20.06	40	11.80	22	6.49	338	99.71	0	0	1	0.295	0	0	1739	474	2213	
3	19	344	187	54.36	78	22.67	62	18.02	11	3.20	338	98.26	6	1.744	0	0	0	0	1855	1384	3239	
4	20	366	177	48.36	96	26.23	65	17.76	22	6.01	360	98.36	6	1.639	0	0	0	0	2169	940	3109	
5	20	327	145	44.34	95	29.05	65	19.88	12	3.67	317	96.94	10	3.058	0	0	0	0	1327	584	1911	
GJ	98	1748	993	56.81	400	22.88	255	14.59	77	4.41	1725	98.68	22	1.259	1	0.057	0	0	8581	3507	12088	

Arsimi i mesëm i ulët, niveli 6-9

Klasa	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve	Suksesi pozitiv	Suksesi i pamjaftueshëm	Numri i mungesave
-------	----------------	--------------	-----------------	-------------------------	-------------------

		Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Përcillen në riprovim						Përsërisin klasën		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej				
		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%				Nr	%		
6	19	364	27.2	95	26.1	62	17.0	9	2.4	26	7.2	26	7.1	2	5.4	2	5.4	52	14.3	98	26.9	1	0.2	787	4893	
7	18	316	24.4	57	18.1	67	21.2	1	3.8	21	6.7	17	5.3	2	6.6	1	3.2	65	20.6	10	3.2	0	0	101	3892	
8	18	368	26.1	85	23.1	59	16.2	9	2.4	24	6.7	39	10.6	2	5.7	2	5.7	67	18.2	11	3.0	1	0.2	134	4042	
9	18	331	23.3	86	26.3	54	16.3	4	1.2	22	6.6	33	9.9	1	5.7	1	5.7	58	17.5	11	3.3	0	0	132	4356	
G	73	137	25.3	32	23.4	24	17.5	3	2.4	94	68.7	11	8.3	7	5.2	24	17.5	24	17.5	42	31.1	2	0.1	1271	1718	
J		9	3	3	4	2	5	4	7	8	7	5	4	2	2	2	2	2	2	9	1	2	5	4	9	3

Arsimi i mesëm , niveli 10-12

Sa	me	gje	ve	Suksesi pozitiv	Suksesi i pamjaftueshëm	MUNGESAT
----	----	-----	----	-----------------	-------------------------	----------

		Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me 1 notë të pamjaftueshme		Me 2 nota të pamjaftueshme		Me 3 e më shumë nota të pamjaftueshme		Gjithsej me nota të pamjaftueshme		Të pa notuar		Të arsyeshme	Të paarsyeshme	Gjithsej
		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
	12	26	17	28	10.5	31	11.6	4	1.5	80	30.0	29	10.9	24	9.0	11	43.4	16	63.3	18	6.7	100	236	3365
10	7		6.37	5																				
	12	25	14	25	9.8	37	14.6	11	4.3	87	34.3	37	14.6	23	9.1	97	38.2	15	61.8	10	3.9	186	215	4021
11	4		5.51																					
	10	24	25	46	18.9	30	12.3	9	3.6	11	45.1	26	10.7	31	12.7	73	29.9	13	53.3	4	1.6	190	144	3355
12	4		10.25																					
	34	76	56	99	12.9	98	12.8	24	3.1	27	36.2	92	12.0	78	10.2	28	37.4	45	59.6	32	4.1	4,77	596	1074
GJ	5		7.32																					

DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS

Raporti i Punës për vitin 2018

Drejtoria e Infrastrukturës gjatë kësaj periudhe kohore ju ka përgjigjur të gjitha kërkesave të qytetarëve, kemi dërguar shkresa për institucione të ndryshme, kemi realizuar projektme dhe menaxhime të kontratave si për DIL ashtu edhe për drejtoritë tjera kërkuese të komunës. Kemi realizuar projektme për donatorë, marrëveshje me pronarë privat rreth investimeve kapitale dhe përgatitja e dokumentacionit për evidentim në kadastër etj.

Projektet që kanë përfunduar në këtë periudhë kohore :

1. Asfaltimi i rrugës “Minierat” në Hade, 2000 m (financiar nga KEK).
2. Asfaltimi i rrugës “Nora e Kelmendit” në Sibovc, 900 m (financuar nga KEK).
3. Ura mbi lumin Sitnica në Plemetin (projekt i viteve të kaluara)

Punët që janë kryer në këtë periudhë kohore:

1.Moduli i ngjeshmërisë i përfunduar

2.Asfaltimi i rrugëve:Hmidi-Sibo; Sitnica-Plemetin; Bajroni; Sh.polluzha; F.Preniqi

- Asfalimi i Rr. Hamidi- Siboc L=555m ; B=5m
- Sitnica në Plemetin – Obiliq L=655.20m’
- Ndertimi i kanalizimit "Sitnica në Plemetin – Obiliq" L=70m' b=1.8
- Renovimi i rr. “Bajroni – kanalizim trotuar Obiliq”
- Renovimi i rr. “Shaban Polluzha – Obiliq”L=443m' b=5.5m'
- Rruga "Fejzullah Preniqi" Obiliq L=315.0m; B=3.0m *(e papërfunduar vazhdon në vitin 2019).*

3.Hartimi i projekteve Detale

4.Asfaltimi i rr.Bilbilat e Kosovës, te fabrika e ujit dhe Rr. Agro Kor.

- Milloshevë Rr. Bilbilat e Kosovës L=123m; B=4m
- Dardhishtë - Rr. te Fabrika e Ujit Rugova L=388m; B=5m
- Kanali Atmosferik L=360m, B=0.80m Ø630m SN4
- Rr. Agro Korit (*e pa përfunduar vazhdon në vitin 2019).*

5 Rrugë me asfalt- “Nuhi Kelmendi”, 770 m (financuar nga MAPL).

6. Rrugë me asfalt (pjesa e dytë): Abdullah Qerkezi, Albert Rama, Aziz Zhilivoda, Prapashtica, Mentor Dervishaj, Hamdi Krasniqi dhe Çajupi, 2200 m

7. Rrugë me asfalt dhe kubëza: Zhitia, Tërnavë, Dobratiqi, Gani Shalaku, Isa Zeqiri, Hashim Shalaku (tri segmente), dhe Murat Pllana, 1279 m, (bashkëfinancim MAPL, Demos dhe Komuna e Obiliqit).

8. Trotuari Obiliq-Bakshi, 4500 m, (bashkëfinancim MZHR dhe Komuna e Obiliqit).

9. Rugët: Palaj-Lajthishtë-Sibovc-Shipitullë dhe Hamidi-Plemetin, 7405 dhe 865 m, (Ministria e Infrastrukturës, punët do të zgjasin 24 muaj). (Është përfunduar vetëm pjesa e rrugës Hamidi-Plemetinë me shtresat e zhavorit pjesa tjetër do të vazhdoj këtë vitin 2019).

10. Asfaltimi i rrugëve rurale dhe trotuarëve në Obiliq pjesa e pestë.

- Kozaricë rr Jashanica L=318m'

- Breznicë rr te QKMF L=35m'

- Breznicë rr Lushovit L=842m'

- Graboc rr te Shkolla L=168m'

- Graboc rr Haxhi Hasani L=343m'

- Mazgit rr Gollapi L=467m'

- Mazgit rr Te Xhamia L=190m'

Shipitullë rr Veli Mjeku L=520m' (të gjitha këto rrugë janë të përfunduara me zhavor me te gjitha fraksionet dhe pjesa tjetër e rrugëve në këtë kontratë vazhdon në vitin 2019).

11. Sheshi i Qytetit të Obiliqit në realizim(*bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës vazhdon ne vitin 2019*)

12 Ura në Plemetinë (bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës u përfundua ne vitin 2018)

13. Hartimi i projektit detal "Hartimi i projektit detal Sheshi i Qytetit"

14. Gjatë vitit 2018 në kontratën Kanalizimi fekal dhe atmosferik pjesa e parë janë përfunduar këto degë të cilat i kemi pasur në kontratë:

- Rr. Shaban Shalaku Dardhishtë kanalizim fekal

- Rr. Xhemshir Shalaku Dardhishtë kanalizim fekal

- Rr. Martiret Aliu ne Obiliq kanalizim fekal

- Rr. Lagjeja e re ne Milloshevë te betonjerka kanalizim fekal

- Rr. Te ranqi në Mazgit kanalizim fekal

- Rr Hade kanalizim fekal

- Rr. Raskov-Bakshi kanalizim fekal
- Rr. Sibovcë kanalizim atmosferik
- Rr. Graboc i eperm kanalizim atmosferik

15. Dhe gjithashtu kan përfunduar rrugët:

Kongresi i Manastirit dhe 11 Qershori dhe kanalizimi fekal në kto dy rrugë.

16. Projekti 'Hade e Re,, ku në vitin 2018 është punuar në rregullimin e infrastrukturës nëntoksore janë të ndara 300,000.00€ për vitin 2019 dhe presim me përmirësimin e kushteve atmosferike të vazhdojmë me realizimin e projektit.

DREJTORIA E URBANIZMIT

Raporti i Punës për vitin 2018

Drejtorja e DPUPK-së është e ndarë në katër sektorë, sektori i Urbanizmit, sektori i Pronës dhe Çështjeve pronësore juridike, sektori i Kadastrit dhe Gjeodezisë, ku secili nga këta sektorë është i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme. Të gjithë sektorët punët i kanë përfunduar me përkushtim të plotë duke i respektuar normativat ligjore në fuqi dhe afatet ligjore.

Punët e kryera gjatë viti 2018 ka qenë punë produktive dhe këto punë po i paraqesim më poshtë për çdo sektorë veq e veq:

SEKTORI I PRONËS

Gjatë vitit 2018 Sektori i pronës dhe çështjeve pronësore juridike në kuadër të DPUPK-së ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me plan-program si në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesëmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto aktivitete janë përmbyllur me sukses brenda afateve ligjore gjatë tërë viti.

Përveç punëve të cilat janë kryer si në bartjen e pronës në regjistrimin dhe fshirjen e hipotekës dhe regjistrimin e ngarkesave të tjera ligjore si barrë tatimore. Sektori jonë ka kryer edhe punë më specifike si në vijim :

- Gjatë muajit prill me iniciativën e Kryetarit të Komunës kemi përgaditur Propozim Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonat kadastrale Obiliq-Milloshëvë dhe Babimoc dhe pas aprovimit në Kuvend të këtij propozim Vendimi janë dhënë në shfrytëzim afatgjatë gjithsej 13 prona komunale me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë biznesore. Vlenë të theksohet se një proces i tillë është përmbyllur në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi .

Pastaj gjatë muajit shtator po ashtu me iniciativën e Kryetarit të Komunës kemi përgaditur Propozim Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale Babimoc dhe pas aprovimit në Kuvend të këtij propozim Vendimi nëpërmjet tij synohet të jepen në shfrytëzim afatgjatë edhe (4) prona komunale me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë biznesore për ndërtimin e fabrikave të ndryshme dhe për zbutjen e papunësisë brenda Komunës së Obiliqit. Vlenë të theksohet se për këto parcela ende nuk është përmyll procesi dhe aktualisht janë të shpallura në konkurs publik .

- Me kërkesën nr XIV-90 të dt.14.08.2018 nga Drejtoria për Kulturë për Rini dhe Sport, Sektori për Pronë ka filluar procedurën për dhënien në shfrytëzim afat-shkurtër të Shtëpisë së Kulturës e cila gjendet në Milloshevë duke përgaditur kështu Propozim Vendimin për Kuvend me nr.II-774 të dt. 13.09.2018 nëpërmjet të cilit synohet të ipet në shfrytëzim në afat kohor prej (5) vite me qëllim të realizimit të aktiviteteve kulturore, programeve edukative dhe veprimtarive të ndryshme profesionale me karakter kulturor dhe sportive .

- Punë tjetër e cila është realizuar dhe e cila është përshëndetur nga ana e qytetarëve të fshatit Shipitullë, Hade dhe Caravodicë ka qenë kërkesa drejtuar Kuvendit Komunal për Plotësim ndryshimin e Vendimit I-95 I dt. 30.10.2013 nëpërmjet të cilit përveq banorëve të zhvendosur të Lagjes Shala-Fshati Hade të përshihet edhe Fshati Shipitullë, Hade dhe Caravodicë të cilët janë në proces të shpronësimit të lirohen nga taksat administrative komunale për kërkesat për fletë poseduese, kopje plani, bartje pronës, kërkesat për kushtet ndërtimore, kërkesa për leje ndërtimore si dhe pagesa e lejes ndërtimore. Qytetarët në raste të caktuara kanë shprehur gatishmërinë që pronën e tyre të paluajtshme ta kalojnë në pronësi të Komunës me qëllim të ndërtimit të rrugëve publike, për këto raste Drejtoria për Planifikim Urban - Pronë dhe Kadastër ka kërkuar nga Kuvendi Komunal që të marrë Vendim që për këto raste shpenzimet që kryhen te noteri dhe brenda administrates komunale të barten nga Komuna. Kërkesa është aprovuar nga ana e Kuvendit Komunal dhe Vendimi në fjalë tani më ndodhet në proces të konfirmimit të Ligjshmërisë nga ana e MAPL-së .

- Punë tjetër e cila vlenë të përmendet është se pas një procesi të gjatë të shpronësimit rreth qështjes së Unazes së Qytetit në Rrugën Kryesore dhe pas një procesi të gjatë gjyqësor është arritja e marrëveshjes për kompenzim me familjen Berisha .

- Me dt.17.07.2018 është nënshkruar Memorandumi mes Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Kryetarit të Komunës së Skënderajt, Kryetarit të Komunës së Drenasit, Kryetarit të Komunës së Vushtrisë dhe Kryetarit të Komunës së Obiliqit, që pasuria natyrore e bjeshkëve të Qyqavicës e cila shtrihet në territorin e pesë komunave të përfshira nëpërmjet këtij memorandumi dhe të shpallen zonë me interes të përgjithshëm, pas këtij memorandumi Drejtoria e Urbanizmit ka organizuar takime me përfaqësuesit e Komunave të lartëcekura me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve, ku më pas nga sektori i Pronës ju ka dërguar në Kuvend edhe Propozim Vendimin për shpalljen me interes të kësaj Zone e cila shtrihet në territorin e Komunës së Obiliqit .

- Drejtoria e Urbanizmit ka bërë pagesën e pjesëshme për AKP-në ku nëpërmjet MMPH-së kemi arritur të bëjmë shpronësimin e Stadiumit “Agron Rama” në Obiliq .

- Në vazhden e punës dhe aktiviteteve të cilat i zhvillon ky sektor është edhe Procedura e Shpronësimit, procedur kjo e cila sipas Ligjit inicohet në rastet kur Organi Shpronësues në këtë rast Komuna synon të realizoj një projekt të ligjshëm publik dhe kur ky qëllim nuk mund të realizohet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit. Duke u bazuar në këtë që u cek më sipër DPUKP-ja respektivisht ky sektor për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik respektivisht për ndërtimin e Sheshit të Qytetit ka përgaditur propozim Vendimin për Kuvendin Komunal për shpalljen me interes të përgjithshëm për ato njësi kadastrale të cilat do të preken nga procesi i shpronësimit për ndërtimin e Sheshit të Qytetit në Rr. “Hasan Prishtina” dhe tani kjo procedurë në pajtim me Ligjin është duke u zhvilluar.

•Pjesmarrja në takime tjera nuk ka munguar gjithmonë në ato që janë të favorshme dhe të domosdoshme për punën efektive të Drejtorisë së Urbanizmit, si: Punëtori së bashku me komunat tjera në prezentimin e udhëzimit administrative për hartimin dhe miratimin e projekt Ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim të Pronës Komunale, pastaj pjesmarrja në trajnime të ndryshme lidhur me procedurat e Prokurimit në mënyrë elektronike të organizuar nga KRPP.

•Drejtoria e Urbanizmit brenda Komunës ka kryer me përgjegjësitë plotë punët dhe stafi ka qenë i përfshirë në shumë komision si në vijim :

- Në kuadër të komisionit për ankesa kemi kryer punën lidhur me shqyrtimin e ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

- Në kuadër të Komisionit për verifikimin e gjendjes në terren për kushte ndërtimore së bashku me dy anëtarët e tjerë të Komisionit kemi kryer punën me përgjegjësi të plotë ku kemi arritur gjithsej (32) raste.

SEKTORI I GJEODEZISË DHE KADASTRIT

• Gjatë vitit 2018 **Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër** ka arritur që të tejkalojë pritjet e të hyrave vetanake.

Në këtë periudhë 1-Vjeçare kemi pas takime të rregullta me stafin e Sektorëve tjerë ku jemi konsultuar për arritjen e një pune sa më të suksesshme për kryerjen e të gjitha punëve që na përkasin si Sektor. Sektori për Gjeodezi dhe Kadastër nuk ka pasur vërejtje nga qytetarët që jemi shumë mirënjohës dhe besoj se angazhimi në të ardhmen do të jetë në ngritjen e cilësisë dhe respektin e Qytetarve.

• Në këtë Periudhë kemi pas Trajnime nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për Avancimin në programin e SIKTK-së kështu që jemi të kënaqur me konsultime dhe trajnime të ndërsjella dhe jemi shumë mirënjohës për interesimin e tyre për mbarëvajtjen e punës në Sektorë.

Në këtë periudhë kemi qenë të angazhuar për shpronësimin e Objektivit i cili gjendet afër Postes i cili lokacion është i caktuar për ndërtimin e Sheshit të Qytetit dhe i kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e shpronësimit harmoni me Ligjin .

• Sektori jonë gjatë vitit 2018 ka përgatit dokumentacionin për dhënen në shfrytëzim për 99-vite të pronës në zonat kadastrale Babimoc dhe Milloshevë dhe ky Proces ka përfunduar me sukses.

• Kemi marrë pjesë në Trajnime të ndryshme, si për Ligjin e Legalizimeve, pastaj për sistemin SIMBNJ-të organizuar nga MAPL, trajnimi nga Niveli qendror i Prokurimit për sistemin e E-Prokurimit elektronik, pastaj trajnimi për procedurat e përdorimit të Intranetit të organizuar nga MAPL si dhe shumë trajnime të tjera që janë të lidhura me sektorët në fjalë.

Sa i përket emërtimeve të rrugëve sipas kërkesave të banorëve ne kemi emëruar gjatë vitit që lam pas (6) rrugë në bashkëbisedime me banorët dhe me pelqimin e tyre (3) rrugë janë emëruar nga lista rezervë dhe (3) nga to janë miratuar nga Kuvendi Komunal që nuk janë në listen rezervë por që janë emëruar sipas dëshires së banorve të lagjes.

Gjatë vitit 2018 kemi pas gjithsej 1356 -kërkesa për lëndë të ndryshme ku do të paraqesim si në vijim:

- 1.Kontrata të shtitblerjes ; 738
- 2.Kontrata për ndarjen e paluajtshmërisë ; 48
3. Aktvendime të Trashëgimisë; 106
- 4.Regjistrim i Hipotekës ; 64
- 5.Fshirje e Hipotekës; 28
- 6.Kontrata të faljes (Dhurimi); 87
- 7.Parcelizim; 83
- 8.Bashkim dhe ndarje; 12
- 9.Kthim i Kufijve; 00
- 10.Regjistrim i Barres Tatimore; 08

11. Regjister i Kordinatave; 109
12. Regjistrim i Parcelave; 56
13. Modifikim për Personin; 23
14. Vendim Gjyqësor; 10
15. Kontrata te Qiramarrjes se Objektivit te Banimit; 00
16. Kontrata të këmbimit; 14
17. Parcelizim dhe Rregullim i Kufirit; 00
18. Vendim i Shpronësimit; 41
19. Masa e sigurisë nga - Gjykata; 08
20. Caktim i Kufirit; 01
21. Rexhistrim i Objektivit; 04
22. Urdhër nga Përmbartuesi; 00
23. Historiati i Pronës; 03
24. Bashkim i Parcelave; 19
25. Ndarje Faktike; 00
26. Kontrata për ndarje në Bashkëpronësi të Paluajtshmërisë; 06
27. Kontratë për Qiramarrje për 99-Vite; 09
28. Korigjim i sipërfaqeve të Parcelave; 06
29. Aktvendim i Qeverisë; 03
30. Kontratë në Dorëzim të Paluajtshmërisë; 01
31. Azhurim i Parcelave; 04
32. Kontratë mbi Mbajtje të Përjetëshme; 00

TOTALI - i të hyrave në këtë sektorë është : 77,824.00€

PËRMBLEDHJE E PUNËVE NË SHËRBIM TË DREJTORIVE BRENDA KOMUNËS

- Në vijim do të përshkruajm një përmbledhje në vija të trasha të punëve gjatë vitit 2018. Në raport do të përfshihen punët e përfunduara nga ky sektor në aspektin profesional sipas kërkesave të parashtruara nga ana e drejtorive të Komunës së Obiliqit të cilat lidhen drejtpërdrejt me punë profesionale në terren e që janë situacione të ndryshme për nevoja të projektimit, matje të parcelave – kufijeve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve, elaborate të shpronësimit dhe identifikime të ndryshme me matje.
- Në cilësinë e anëtarit të Komisionit për verifikimin e gjendjes faktike në terren për caktimin e kushteve ndërtimore është punuar shumë në vitin 2018 pasi që natyra e punës kërkon dalje në terren në vendngjarje dhe në rastet kur punët kanë filluar bëhen matjet për të përcaktuar pozicionin e sakt të objektivit.
- Pasqyra e lëndëve të përfunduara në kuader të mirembajtjes së rregullt të kadastrit do të paraqitet me një tabelë të veçant dhe do të bashkangjes këtij raporti ndërsa ky raport me shkrim do të përfshijë vetëm punët dhe shërbimet që janë kryer sipas kërkesave të Drejtorive brenda Komunës.

- Në z.k. Bakshi janë bërë matjet për nevoja të projektimit të kanalizimit fekal në gjatësi prej 867.66 m², përveq matjeve është punuar edhe situacioni në terren.
- Gjithashtu gjatë realizimit të punëve në këtë projekt ka pas edhe kërkesë për matje të kufijve të parcelave e cila punë ka ardh si rezultat i kundërshtimeve të pronarëve gjatë punimeve në realizimin e projekti të kanalizimit.
- Në z.k. Mazgit kemi bërë matjet gjeodezike për hartimin e projektit për rregullimin e parkut të fshatit. Matjet gjeodezike janë bërë në një sipërfaqe prej 20.000 m², gjithashtu përveq matjeve është punuar situacioni me pamje horizontale dhe vertikale të terrenit ne dëg file.
- Gjithashtu në z.k. Mazgit matjet e kufijëve të parcelës pronë komunale parcelë dhe rruge afërsisht 500 m.
- Në z.k. Milloshevë janë bërë matjet për projektin e ndërtimit të Ambulances dhe fushës sportive në Pronen Komunale.
- Në z.k. Obiliq janë bërë matjet gjeodezike situacioni në sipërfaqe afërsisht 19.000 m² për rregullimin e parkut te shkolla fillore “Pandeli Sotiri” Obiliq i Vjetër. Situacioni i punuar me pamje horizontale dhe vertikale ne dëg file.
- Matjet gjeodezike situacioni i terrenit në Qendër të qytetit te objekti Lamella A1 .
- Matjet gjeodezike sheshi i qytetit situacioni me siperfaqe 11.196 m² për nevoja të projektimit të sheshit.
- Matjet gjeodezike pas përfundimit të projektit realizues rruga “Nuhi Kelmendi” për të përcaktuar saktësisht gjatësinë e punuar të rrugës, për të njëjtën është punuar situacion ne dëg file.
- Matjet e kufijëve të rrugës “Fejzullah Preniqi” për nevoja të ndërtimit të rrugës dhe zbatimit të projektit.
- Matjet e pronës komunale Obiliq i Vjetër për konstatimin e pozicionit të objektit të ndërtuar pa leje ndërtimore.
- Hartimi i elaboratit të shpronësimit për nevoja të ndërtimit të sheshit në qytetin e Obiliqit.
- Në z.k. Sibovc matje gjeodezike për rregullimin e parkut të oborrit të Xhamisë së fshatit Sibovc.
- Në cilësin e anëtarit të komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore është punuar në gjithësejt (32) lëndë gjatë vitit të kaluar, në disa lëndë janë bërë matjet për përcaktimin e pozicionit të objekteve dhe janë punuar skicat së bashku me raportin e komisionit.
- Ky raport përmban kryesisht punët nga lëmia e punëve ingjinjrike gjeodezike për projekte të ndryshme komunale ndërsa punët në lëmin e mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit do ti paraqesim në formë tabelare për çdo zonë kadastrale si dhe totali i lëndëve të përfunduara në vitin 2018.

Pasqyra vjetore e lendeve nga rexhistri i fletëparaqitjeve për vitin 2018

Zona Kadastrale	Ndarje	Bashkim	Shpronsim	Korigjim Kufirit	Total
Babimoc	4	7	4	0	15
Bakshi	2	1	0	0	3
Breznica	7	6	0	0	13
Caravodic	2	0	0	0	2
Graboc	0	0	0	0	0
Hade	2	0	0	0	2

Hamidi	0	0	0	0	0
Kryeshevc	6	3	0	0	9
Leshkofshiq	2	0	0	0	2
Llazarevë	2	0	0	0	2
Milloshëvë	9	5	7	0	21
Mazgit	11	2	2	1	16
Obiliq	37	12	4	0	53
Plemetin	19	3	0	0	22
Raskovë	8	0	0	0	8
Sibovc	4	1	0	0	5
Shipitullë	20	0	0	0	20
Total	135	40	17	1	193

SEKTORI I URBANIZMIT

Gjatë vitit 2018 sektori i **urbanizmit** në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto fushëveprime janë përmbyllur me sukses brenda afateve ligjore gjatë tërë vitit.

- Udhëzimi administrative me nr.06/2017, na ka obliguar që të bëjmë ndryshime si në formular për aplikim poashtu edhe në vendime të paisjës së palëve me leje ndërtimore dhe këtë formë kemi filluar ta aplikojmë gjatë vitit 2018.
- Në bazë të udhëzimit administrative 02/2018 kemi bërë ndryshimin e tarifave për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe infrastruktur, e cila është aprovuar nga MMPH-ja dhe tani në vitin 2019 do të fillojmë aplikimin e tarifës së re.
- Kemi filluar së bashku me komunat tjera në takime të ndryshme të organizuara nga MMPH-ja në bashkëpunim me OSBE-në dhe USAID-in, mënyrën se si do të fillojmë me aplikimin e Ligjit të ndërtimeve pa leje me 06/L-024, e poashtu edhe harmonizimin e udhëzimeve administrative në mënyrë që të jenë sa më të aplikueshme nga qytetarët, ku pritet mbrenda këtij viti të aprovohen dhe të fillojmë me paisjen e qytetarëve me vendime për legalizim të objekteve.
- Pjesmarrja në takime tjera nuk ka munguar gjithmonë në ato që janë të favorëshme dhe të domosdoshme për punën efektive të sektorit e Urbanizmit, si:
 - Punëtorja së bashku me komunat tjera në prezentimin e udhëzimit administrative për hartimin dhe miratimin e Hartës zonale të Komunës dhe U.A. për planifikim hapsiror me pjesmarrjen në Kosovë, organizuar nga MMPH-ja me përkrahjen e USAID-it partneritetet për zhvillim.
 - Pastaj pjesmarrja në trajnimin lidhur me procedurat e Prokurimit në mënyrë elektronike të organizuar nga KRPP.
 - Pjesmarrje në trajnimi i organizuar nga MAPL-ja dh USAID-i për burime njerëzore-programi SIMBNJ, pjesmarrja në trajnimin – Moduli i aplikimit On-line të certifikatave të gjendjes civile, si dhe ri-prezentimi i gjurmimit të lejeve ndërtimore.
 - Duhet të cekim pjesmarrjen në takime të ndryshme të organizuara nga MAPL-ja lidhur me harmonizimin e punëve Ministri –Komunë për aplikimin e procedurave ligjore për Planifikim Hapsiror.
 - Sektori Urbanizmit sa i përket punëve brenda Komunës, ka kryer me përgjegjësi të plotë punët si anëtarë të komisioneve për vlerësim të tenderëve.
 - Poashtu me komisione janë kryer punë lidhur me shqyrtimin e ankesave të qytetarëve lidhur me vendimet e inspektorëve të ndërtimit për rrënim.

- Punë tjetër si anëtar të komisionit është edhe hartimi i rregullores për banim në bashkëpunim me Developing Together.
- Jan paisur palët me dokumente në mënyrë që t'iu mundësohet aplikimi në Ministrinë e Bujqësisë për përfitim të granteve qeveritare e poashtu edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me kërkesat e tyre për ndërtimin e shtëpive për të rikthyerit dhe për minoritetet, ju kemi kthyer përgjigjeje në kërkesat e tyre për zonat se ku lejohet ndërtimi e ku jo.
- Poashtu edhe kemi pregaditur dokumentacionin për të shpallur tenderin për hartimin e Planit Zhillimor, duke shpresuar se ky Plan Zhvillimor do të na ndihmojë në zgjidhje sa më të mirë të kërkesave dhe nevojave të Komunës gjithmonë në të mirë të qytetarëve.
- Kemi filluar në pregaditjen e dokumentacionit për të filluar procedurën e dhënjës së tokës komunale me koncesion për ndërtimin e një objekti kolektiv i cili do të shfytëzohej për raste sociale ku sado pak do të zgjidhje qështja e banimit për rastet në nevoj.
- Jemi ndarë të knaqur çdo herë me Inspektoratin e MMPH-së , lidhur me kontrollat e kohpaskohëshme që i bëjnë sektorit tonë për rrjedhën e punëve lidhur me paisjen e palëve me leje ndërtimore dhe zbatimin e proceduarve ligjore në përpikmëri.
- Pastaj me kërkesa të ndryshme ju kemi drejtuar Kuvendit lidhur me marrjen e vendimeve të ndryshme që do të bëjnë zgjidhje nevojave dhe kërkesave të qytetarëve.
- Rast konkret me kërkesën e DPUPK Kuvendi ka marrë vendim për lirim të të gjitha rasteve sociale nga taksat dhe tarifatat komunale për tu paisur me leje ndërtimore.
- Kërkesë tjetër nga DPUPK-ë për Kuvend ka qenë edhe si të bëhet zgjidhje për qytetarët të cilët kërkojnë të ndërtojnë në parcelat që ndodhen nën masën e komasacionit, ku kanë të ndërtuar objekte të tjera edhe pa qenë parcelat nën masën e komasacionit, ku ky problem ka atakuar një numër të madh të banorëve të cilëve nuk kemi mundur t'iu bëjmë zgjidhje, e kërkesat kanë qenë të mëdha nga banorët për ndërtim.
- Probleme të tilla për pamundësin e palëve për tu paisur me leje ndërtimore kemi pasur në raste të shumta, pasi që Komuna jonë është zonë e Interesit shtetëror, nuk kemi pasur mundësi për t'iu paisur me leje ndërtimore në afërsi rreth 1000 metra nga Kosovës "B", nuk kemi pasur mundësi poashtu edhe paisjen me leje ndërtimore në rreth 700 metra në afërsi të "Kosovës A" pastaj rreth elektrobartjës, në Zonën e Mbrojtur të Gazimestanit, në tokat të cilat prekën nga sistemi i ujitjes, ato në afërsi të kanalit të "Ibër-Lepencit" .
- Pastaj mos paisja me leje ndërtimore në zonat e mihjeve sipërfaqësore për të cilët ekziston vendimi që nga viti 2004 që janë shpallë zona të interesit shtetëror dhe nuk lejohet ndërtimi, mirëpo që nga ajo kohë e sot banorëve nuk iu është bërë zgjidhje nga qeveria sepse nuk është bërë dislokimi i banorëve dhe kanë mbetur në gjendje mjaft të rëndë pasi familjet janë rritur e nuk kanë pasur mundësi ndërtimi të objekteve tjera në ato parcela, kjo ka qenë një barrë mjaft e rëndë për Drejtorinë e Urbanizmit, sepse nuk kemi mundur t'iu dalim në ndihmë qytetarëve tanë, sepse PZHKU dhe vendimet e ndryshme nuk na kanë lejuar t'iu paisim palët me leje ndërtimore ,e pamundësia për tju bërë zgjidhje tjetër për mes formave të shpronësimit apo gjetjes së një lokacioni të ri, nuk kemi pasur mundësi për shkakë të buxhetit të limituar.
- I kemi paraqitur Kuvendit edhe tarifatat e aprovuara nga MAPL, që të marrim edhe aprovimin nga Kuvendarët në mënyrë që të filloj aplikimi I kësaj tarife në këtë vit.

LËNDËT DHE TË HYRATË NË SEKTORIN E URBANIZMIT

- 48 vendime për kushte ndërtimore,
 - 43 vendime për leje ndërtimore,
 - 1 leje përdorimi,
 - 4 leje rrënimi,
 - 11 vendime për refuzim,
 - 13 përgjigjeje palëve,
- Gjithashtu kemi bërë njoftimepër qytetarë në kërkesat e ndryshme.

II VROJTIMIT TE LEJEVE			FAZA I		FAZA II		
Nr. Lend	Emri i aplikuesit	Kategoria I, II	KUSHTET NDËRTIMORE		LEJE NDËRTIMORE		PAGESAT DHE TAKSA Pagarëti i ndërtimit m ²
			ndërtimore	publike	leje ndërtimit	Vendimi për leje ndërtimit	
3690	Bast trade	II	20.02.2018	10 €	7.03.2018		
2984	Bajram Mirena	I	12.02.2018	10 €	7.03.2018		
6409	QKMF	II				19.03.2018	34.0
5276	Zijadin Hashani	I	08.03.2018	10 €	23.03.2018		
5885	ADE Group	II	14.03.2018	10 €	27.03.2018		
5115	Uje Rugove	II	06.03.2018	10 €	27.03.2018		
7131	Kujtim Preniqi	I	27.03.2018	10 €	30.03.2018		
5887	Sami Gillareva	I	14.03.2018	10 €	03.04.2018		
7285	Ajet Preniqi	I	29.03.2018	10 €	05.04.2018		
7111	Viva Fresh	II	27.03.2018	10 €	16.04.2018		
8510	Bast Trade	II		10 €		11.04.2018	2200
8242	Zijadin Hashani	I		10 €		10.04.2018	202.7
8253	Kujtim Preniqi	I		10 €		10.04.2018	87.60
8858	Ujë Rugovë	II		10 €		17.04.2018	788.0
9456	Bajram Mirena	I		10 €		20.04.2018	99.25+104.
9360	Ajet Preniqi	I				19.04.2018	87.38+88.6
8576	Festim Matoshi	I	11.04.2018		25.04.2018		
9741	Qendrim Saraqi	I	23.04.2018	10 €	08.05.2018		
11269	Bashkim Grajgevc	I	10.05.2018	10 €	17.05.2018		
11267	Hetem Mirena	I	10.05.2018		11.05.2018		
11260	Shaban Mirena	I	10.05.2018		11.05.2018		
11263	Xhemajl Mirena	I	10.05.2018		11.05.2018		
11266	Faik Mirena	I	10.05.2018		11.05.2018		
11288	Afrim Mjekiqi	I	10.05.2018		15.05.2018		
11285	Rasim Mjekiqi	I	10.05.2018		15.05.2018		
11540	QKMF	II	14.05.2018		15.05.2018		
11497	Adem Dragusha	II	11.05.2018	10 €	17.05.2018		

10547	A.D.E.Group	II		10 €				02.05.2018	15.05.2018	956.20 +45.94	1914.09€
11304	Sami Gllareva	I		10 €				10.05.2018	23.05.2018	108.93	208.10€
13353	Bashkim Grajçevci	I		10 €				31.05.2018	05.06.2018	123.04 +123.04	718.55€
12428	Florim Grajçevci	I	28.05.2018	10 €		07.06.20					
12430	Burim Grajçevci	I	28.05.2018	10 €		07.06.20					
8337	Bashkim Ismajli		10.04.2018	10 €	Përgjigje						
2911	Mirvete Krasniqi		12.02.2018	10 €	Refuzim	08.03.20					
5871	Muhamet Berisha		13.03.2018	10 €	Refuzim	06.04.20					
9202	Viva Fresh		17.04.2018	/	Leje rrenii	10.05.20					
12733	Asllan Stullqaku		24.05.2018	10 €	Leje rrenii	25.05.20					
13115	Azem Shala	I	29.05.2018	/	Refuzim	07.06.20					
13116	Sabit Shala	I	29.05.2018	/	Refuzim	07.06.20					
13118	Haqif Shala	I	29.05.2018	/	Refuzim	07.06.20					
12160	Viva Fresh SHPK	II		10 €	Leje ndërti		18.05.2018		13.06.2018	1490.72m	2850.0€
13282	“SHKABAJ”	II	20.06.2018	10 €		20.07.20					
	Behar Mjekiçi		28.05.2018	10 €	Përgjigje						
15415	Asllan Stullqaku		26.06.2018	10 €	Refuzim	25.07.20					
										TOTAL	12.671.07 €
									Shuma totale për gjashtë muaj		
15841	Rasim Mjekiçi	I		/			02.07.2018		17.07.2018		Hade ere
15757	Afrim Mjekiçi	I		/			02.07.2018		17.07.2018		Hade e re
15864	Sherif sh.p.k.	II		10 €			02.07.2018		07.08.2018	1093.23 m	2088.07 €
16564	Mirsade Sharki	I	05.07.2018	10 €		18.07.20					

16646	Njazi Myftari	II							16.07.2018			
17587	Burim Grajqevci	I							30.07.2018		253.42 m	739.99 €
17592	Florim Grajqevci	I							30.07.2018		253.42 m	739.99 €
17666	Agim Grajqevci	I	13.07.2018				25.07.20					
18345	Festim Matoshi	I						19.07.2018			158.34 m	462.35 €
18768	Flamur Krasniqi	I	23.07.2018				25.07.20					Hade e re
18763	Elton Krasniqi	I	23.07.2018				25.07.20					Hade e re
18775	Ilir Krasniqi	I	23.07.2018				25.07.20					Hade e re
18782	Milaim Krasniqi	I	23.07.2018				25.07.20					Hade e re
18772	Sevdije Berisha	I	23.07.2018				25.07.20					Hade e re
18778	Suzana Berisha	I	23.07.2018				25.07.20					Hade e re
19070	Hetem Mirena	I						25.07.2018		30.07.2018		Hade e re
19071	Shaban Mirena	I						25.07.2018		30.07.2018		Hade e re
19420	Xhevat Xhota	I	30.07.2018									
19579	Faik Mirena	I							31.07.2018			Hade e re
19577	Xhemajl Mirena	I							31.07.2018			Hade e re
18348	“Berto”Sh.p.k.	II	19.07.2018									
20987	Asllan Stullqaku	I	10.08.2018				13.08.20					
20995	Shkabaj sh.p.k	II						10.08.2018		14.08.2018	10.902 m	20822.8 €
21573	Mentor Pllana	II	15.08.2018				17.08.20					
21961	Adem Hoti	I	22.08.2018									
23369	Sabrije Jetishi	I	05.09.2018									
23830	Njazi Miftari	II						07.09.2018		10.09.2018	1390.88m	3630.00 €
23270	Asllan Stullqaku	I						04.09.2018		06.09.2018	363.8 m ²	421.73 €

21304	Sevdije Berisha	I							14.08.2018	07.09.2018		Hade e re
21308	Suzana Berisha	I							14.08.2018	07.09.2018		Hade e re
21297	Flamur Krasniqi	I							14.08.2018	07.09.2018		Hade e re
21296	Eltion Krasniqi	I							14.08.2018	07.09.2018		Hade e re
21299	Ilir Krasniqi	I							14.08.2018	07.09.2018		Hade e re
21301	Milaim Krasniqi	I							14.08.2018	07.09.2018		Hade e re
25600	QKMF	II							21.09.2018	24.09.2018	304.58m ²	
24651	BPHome Invest		13.09.2018	10€	Refuzim	15.10.20						
25105	Meso Produkt	I	19.09.2018	10€		08.10.20						
25190	Nazmi Ramadanaj	I	18.09.2018	10€		03.10.20						314.77€
23580	Behxhet Krasniqi	I	06.09.2018	10€		03.10.20						
25348	Florentina Preniqi	I	19.09.2018	10€		03.10.20						
24231	Izet Gashi	I	12.09.2018	10€		03.10.20						
25066	Leonora Halili	I	18.09.2018	10€		03.10.20						
26373	Kadri Morina	I	01.10.2018	/		16.10.20						Hade re
26823	"HOME INVEST"	II		10€					03.10.2018	01.11.2018	45108.9m ²	pagesa e pjes
28547	Contour Global Kosovo	II		10€					22.10.2018	29.10.2018	60.0m ²	5400.39€
28160	Skender Llugiqi	I	17.10.2018	/	Refuzim	29.10.201						
28490	Drejtorinë e Kulturës	II		/					19.10.2018	01.11.2018		/
29019	Bislim Behrami	I	26.10.2018	10€		07.11.20						
27613	Leonora Halili	I		10€					11.10.2018	02.11.2018	80.0m ²	Rindërtim
29493	Ibrahim Morina	I	01.11.2018	10€		04.12.20						
29613	Sadri Mehmeti	I	02.11.2018	10€		26.11.20						
29896	Florentina Preniqi	I		10€					07.11.2018	09.11.2018	70.0m ²	133.70€

29939	Meso ProduktDoo	I		10€			08.11.2018		09.11.2018	250.0m ²	477.50€
30064	Xhafer Krasniqi	I	08.11.2018	10€		15.11.20					
30066	Sylejman Krasniqi	I	08.11.2018	10€		15.11.20					
30688	Bujku N.P.Sh	I		10€			15.11.2018		16.11.2018	212.1m ²	405.2€
30067	Habibe Krasniqi	I	08.11.2018	10€		20.11.20					
30853	"Bast Trade"	II	16.11.2018	10€		05.12.20					
1306	rej. E Sherbimeve Publike dhe H	II		/		Leje rrenim 03.12.20					
30990	Contour Global Kosovo	I		10€			19.11.2018	Në procedur			
32247	Sylejman Krasniqi	I		10€			06.12.2018		10.12.2018	241.8m ²	706.22€
32249	Xhafer Krasniqi	I		10€			06.12.2018		10.12.2018	241.8m ²	706.22€
32188	Adem Hoti	I		10€			05.12.2018		10.12.2018	210.5m ²	614.67€
32150	Bast Trade	II		10€			05.12.2018		10.12.2018	2200m ²	4202.0€
31845	Gani Berisha	II	03.12.2018	10€		11.12.20	Leje përdorin				
32932	"Bast Trade" objekti I vjetër	II		10€			17.12.2018		18.12.2018	10413.64	9890€
32483	Milazim Zhegrova		12.12.2018	10€	Refuzim	15.01.20					
32960	Eco Kos LLC		17.12.2018	10€	Njofim	15.01.20					
33282	Rexhep Zymeri	I	21.12.2018	10€		Në procec					
	BP"Home Invest"								esa e dy pjesëve		4231€
33481	NTP.Medika	II	26.12.2018	10€		23.01.20					
33356	Skender Llugiqi	I	24.12.2018	/	Refuzim	22.01.20					
11649	Haki Zeqiri		15.05.2018	/	Përgjigje	18.05.20					
730	Agjensioni Katastral		03.08.2018	/	Përgjigje	03.08.20					
18705	Naser Berisha		23.07.2018	/	Përgjigje	13.08.20					

14119	Mehdi Aliju		11.06.2018	/	Përgjigje	18.06.20				
28510	Xhamija		22.10.2018	/	Përgjigje	30.11.20				
26775	Izedin Ahmeti		03.10.2018	/	Përgjigje	18.10.20				
25935	Hajrullah Preniqi		25.09.2018	/	Përgjigje	27.09.20				
	Ferit Hashani			/	Përgjigje	07.05.20				
27380	Faton Beka		09.10.2018	/	Njofitim	30.11.20				
									TOTAL	79 127.67€
									a totale për vitin 2018 nga DPUPK është	<u>156 951</u>

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE MJEDIS

Raporti i Punës për vitin 2018

Aktivitete të cilat zhvillohen në kuadër të kompetencave të drejtorisë:

- 1. Monitorimi i gjendjes mjedisore;** ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës përmes raporteve mujore nga TC-A, TC-B, Divizionit të Qymyrit dhe raportit të Institutit Hidrometeorologjik (IHMK), ku përgjatë vitit 2018 kishte kalime në pjesën e dytë të vitit prandaj DMM ka ngrit si shqetësim duke u bazuar në raportin e KEK ku shohim se kemi tejkalim të parametrave në TC-A dhe TC-B, të publikimi i AMMK –së, raporti mujor mbi cilësinë e ajrit sipas monitorimit nga IHMK, nga muaji gusht deri në muajin dhjetor kishte tejkalime të parametrave. Duke u bazuar në raportet e lartshënuara ne kemi ngritë shqetësimin me reagime në MMPH, AMMK dhe KEK në formën e shkruar dhe elektronike.
- 2. Pastrimi dhe larja e trotuareve dhe rrugëve – plani i punës me kompaninë “Pastrimi”;** Rrugët e kategorisë së parë (zona e parë) një herë në javë, rrugët e kategorisë së dytë dy herë në muaj dhe sipas kërkesave të DMM-së
- 3. Mirëmbajtja e shesheve dhe parqeve – kontrata** “Mirëmbajtja e parqeve, shesheve dhe hapësirave gjelbëruese (kontrata dy vjeçare me vlerë 60,000.00€); Mirëmbajtja e parqeve punohet në baza ditore për çdo ditë ndërsa në pllakat përkujtimore tri herë në vit dhe sipas kërkesë së DMM,
- 4. Aktivitete ditore në vendbanimet që janë të përfshirë në bartjen dhe grumbullim të mbeturinave komunale – kontrata me kompaninë “Pastrimi” dhe monitorim i vazhdueshëm nga DMM gjatë procesit të marrjes dhe largimit të mbeturinave** (Mënyra e shërbimit të organizuar për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave është i organizuar në formën e bazuar të zonave të banimit brenda komunës. Shpeshtimi i grumbullimit, numri dhe lloji i kontejnerëve është i definuar për tre sektor të banimit:

1. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit kolektiv dhe qendra e qytetit bëhet për çdo ditë

2. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga sektori i banimit individual brenda qytetit bëhet tri herë në javë.

3. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga Sektori i vendbanimeve në zonat rurale në kuadër të komunës bëhet një herë në javë.

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave deri në deponi kryhet gjatë ditës, në disponim i ka tre kamion (dhe i kryen nga dy udhëtime me kamiona special)

- 1. Inspektime ditore – në hudhjen e mbeturinave, respektimin e ligjit dhe udhëzimeve për mbeturinat, transporti i tyre e të ngjashme, inspektime në biznese,**

Në kuadër të kompetencave të Ligjit për mbeturina dhe planit për kontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, përmes inspektorit dhe zyrtarëve komunal mjedisor ka realizuar inspektime (kontrolle) të vazhdueshme për të gjithë ata që kanë vepruar në kundërshtim me udhëzimet dhe Ligjet Mjedisore duke u nisur nga Operatorët Ekonomik (OE), që veprojnë në territorin e Obiliqi, mbeturinat, hudhjen e dheut si dhe kamionëve për bartjen e mbeturinave komunale në Deponinë në Mirash. Në vendin e ngjarjes u bënë procesverbale, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin për mbeturina, dhe u shqiptuan edhe gjoba.

2. **Shënimet e ditëve Mjedisore** – në bazë të kalendarit të koordinuar edhe me MMPH kemi shënuar me aktivitete të ndryshme këto data; 4 Shkurt Dita Botërore e Oqeaneve, 22 Mars Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ujit, 22 Prill Dita Ndërkombëtare e Tokës, 22 Maj Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit, 24 Maj aksioni “Ta pastrojmë Kosovën”, 5 Qershor Dita Botërore e Mjedisit, 22 Shtator Dita Evropiane e Qyteteve pa makina, 8 Nëntor Dita Ndërkombëtare e zonave urbane dhe 11 Dhjetor Dita Ndërkombëtare e Maleve. Ndërsa nga 15 shtator e deri me 15 dhjetor me vendim të Qeverisë, udhëhequr nga taskforce e MMPH, Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe nga taskforce komunale e në bashkëpunim me Let’s do it Kosova të cilët ishin edhe organizator të këtij aksioni me moton “Ta Pastrojmë Kosovën”, për tre muaj aksion pa nderprer DMM ka punuar në largimin e deponive ilegale ku ka arritur me ndihmën e KEK, Deponisë mairash, Kompanisë “Pastrimi”, ojq, shkolla, e shumë qytetarë vullnetar të largojë 36 deponi me 3720 m³ mbeturinë. E nga ky aksion komuna jonë është përfituese e grantit prej 100,000.00 €, përfituese e 32 tabelave vetdijësuese, një parku në kampinë në Plemetin dhe e një sasi kontejnerëve të qytetit që presim t’i marrim këtë vit.

Projektet dhe detyrat që janë realizuar këtë vit:

- Rregullimi i parqeve në Obiliqi; Parku në Mazgit dhe Parku te Obiliqi i vjetër (në fazën e parë)
- Mbjellja e drunjëve urban – gjithsej 1100 trupa në rr:”Hasan Prishtina”, rr:”Llapi” tetë shkolla fillore dhe QMF Milloshevi
- Pastrimi i deponive ilegale – 36 deponi me këto lokacione:
1.Obiliq te komuniteti RAE Rruga “Daut Hashani”, 2.Rruga “Rasim Hashani”, 3.Në Breznicë “Lagjja Koskoviku”, 4.Në Breznicë “Rruga Malsori”, 5.Në Breznicë “Te Shegza”, 6.Në Plemetin “Te Shkolla” e Serbeve, 7.Në Plemetin te Shkolla “Pandeli Sotiri”, 8.Në Milloshevi “Lagjja Qerkezi”, 9.Milloshevi te”Lagjja Shipoli”, 10.Milloshevi Rr:”Ahmet Shipoli”, 11.Obiliq i Vjeter Rr: “Llapi”, te Varrezat, 12.Obiliq i vjeter “Stacioni i Autobusave”, 13.Obiliq i vjeter te oborri e Shkolles “Pandeli Sotiri”, 14.Obiliq i Vjeter Rr: “Mbretëresha Teutë”, 15.Obiliq te Xhamia Rruga “Mbretëresha Teutë”, 16.Bakshi te antena e “RTK-së”, 17.Obiliq i Vjeter Rr: “Llapi”, 18.Siboc Rr: “Afrim Krasniqi”, 19.Shkolla e Sibocit, 20.Te lagjja “Nicaj”, 21.Rr: “Rasim Hashani”, 22.Plemetin te lagjja “Bregaj”, 23.Plemetin Lagjja “Ibrahimi”, 24.Obiliq “Te hekurudha”, 25.Te parku afër hekurudhës, 26.Te Stadiumi “Agron Rama”, 27.Në Mazgit te Varrezat, 28.Rr: Palaj, 29.Shipitull te permendorja e Deshmorit “Faik Mjeku”, 30.Raskovë afër restorant “Arena”, 31.Milloshevi te rrethi afër lumit “Llap”, 32.Obiliq në rr:”Faruk Begolli, 33.Obiliq rr:”Palaj”, 34.Siboc te lagjja “Mexhuani”, 35.Shipitullë tek lagjja “Mjeku”, 36.Obiliq lagjja “Aliu” afër Elektrobartjes.

Gjithësej janë larguar 36 deponi ilegale me mbeturina 3720 (m³).

- **“Rregullimi dhe thurja e varrezave”;** Ka përfunduar rrethoja e varrezave në fshatin Shipitullë ndërsa është në proces Rrethoja në fshatin Dardhishtë.
- **Punimi i pllatove për vendosjen e kontejnerëve** – Furnizimi me kontejner – DMM ka bërë blerjen e 450 kontejnerëve 120L ku shpërndarja e tyre është bërë në mbulimin e territorit të cilët nuk kanë qenë në shërbime (Lajthishtë, Siboc dhe Graboc), dhe kontejner metalik 1.1(28 copë) ku janë shpërndarë në institucione shkollore, ambulante dhe kampi në fshatin Plemetin.
- **Edukimi Mjedisor – trajnimi dhe çmimi i shkollave (pesë shkollat)**
Trajnimet jam mbajtur në shkollat e mesme “Ismail Dumoshi” dhe “17 Shkurt”, në shkollat fillore “Dr.Ibrahim Rugova, “Pandeli Sotiri”, “Aburrahmon Gërguri”, dhe “Hasan Prishtina”.
Shkollat me ambient më të pastër janë shpërblyer pesë (5) shkolla:
“Ismail Dumoshi” “Pandeli Sotiri”, “Dr.Ibrahim Rugova”, “Migjeni” dhe “Hasan Prishtina”.
- **Vendosja e tabelave për Mbrojtjen e Mjedisit;** Janë vendosur 50 tabela informuese dhe vetdijësuese, kryesisht në lokacionet ku janë larguar mbeturinat ilegale.
- Dezinsektimi dhe Deratizimi,

Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit ka filluar implementim e projektit: “Dezinsektimi hapësor” në Obiliq (eliminimin e insekteve, mushkonjave). Paraprakisht për kohën dhe metodën e dezinfektimit përmes mjeteve të informimit u njoftuan qytetarët, organet e rendit, shoqata e bletarëve dhe bletaret. Dezinsektimi është bërë në tri Faza, në tërë territorin e Obiliqit, Deratizimi ka përfunduar në ambulanca dhe çerdhja e Qyteti.

- **Takime dhe inspektime me Inspektoratin mjedisor të MMPH,**
Inspektime të përbashkëta në KEK, Deponina në Mirash, Hekurishte, Fabrika e bllokave në Llazarevë, Peleti në Milloshevë,

- **Inspektime Deponisë Sanitare Mirash, qëllimi dhe rezultati**

Në kuadër të mbikëqyrjes të aktiviteteve, përputhshmërinë e aktiviteteve me standardet dhe normat ligjore për mbrojtje të mjedisit, është bërë kontrolli në Deponinë Rajonale Mirash, zyrtarët mjedisor në bazë të kompetencave kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe konstatojmë se gjendja në deponi krahasuar me vitet e mëparshëm është dukshëm më e mirë, mirëpo prapë janë dhënë vërejtje që të punohet në bazë të planit operativ ditor si në kompaktim, mbulim, shtresim dhe si problem tjetër ishin qentë endacak, shpezët, insektet dhe minjtë për çka kemi kërkuar që për shkak të sezonës verore të bëhet dezinfektimi i deponisë .

- **Inspektime dhe kontrolla autotransportuesve për bartjen e mbeturianeve;** Në kuadër të kompetencave të Ligjit për mbeturina dhe planit për kontroll dhe mbikëqyrje, Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, përmes inspektorit dhe zyrtarëve komunal mjedisor ka realizuar kontrole të vazhdueshme kamionëve për bartjen e mbeturinave komunale në Deponinë regjionale sanitare në Mirash. Inspektimi është bërë me Inspektoret komunal dhe u asistua nga Policia e Kosovës, gjegjësisht Stacioni Policor në Obiliq. Aktiviteti i inspektimit u përqëndrua në rrugën Dardhishtë - Mirash. Gjatë kësaj periudhe u ndaluan të gjitha automjetet transportuese që bartnin mbeturina komunale. Në vendin e ngjarjes u

bënë procesverbale, vërejtje dhe rekomandime në përputhje me Ligjin për mbeturina si dhe u shqiptuan gjoba.

- **Pjesëmarrje në grupin punues me GIZ për garen mjedisi i pastër**
Në garën për mjedis të pastër me GIZ-in kemi fitura 60 kontejner 1.1m³(metalik) dhe 110 kontejner 120 l (të plastikës),
- **Insektime te të gjithë operatorëve që veprojnë në territorin e Obiliqit – raporti dhe plani i veprimit;** DMM ka hartuar planin për kontroll dhe inspektim për të gjithë operatorët që veprojnë në Obiliq, prandaj gjatë këtij viti janë shqiptuar dhjetë (10) gjoba dhe janë plotësuar 60 procesverbale.

Mbikëqyrje të kryerjes së punëve në projektet "Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara", "Mbjellja e drunjve dekorativ" "Rrethoja e varrezave", "Furnizimi me kontejner", "Dezinsektimi, Deratizimi DD", "Vendosja e tabelave, edukimet mjedisore" etj.

- **Vendosja e shportave në qytet;** DMM ka bërë vendosjen e shportave në rrugën kryesore, parqe dhe shkolla.

Gjatë kësaj periudhe kohore, nga zyrtar (inspektor) mjedisor janë kryer gjithsej:

- 57 kontrollime të ndryshme Rutinore - të planifikuar, (plani)
- 33 vërejtje verbale
- 51 inspektime – sipas kërkesave të qytetarëve (lloji inspektimit)

Janë shqyrtuar 99 kërkesave të qytetarëve, gjithashtu janë lëshuar edhe pesëmbëdhjetë (15) Leje Mjedisore duke mbledhur (inkasuar) të hyra në vlerë: **8,175.99 €**, ndërsa duke respektuar UA për Gjobat Mandatore kemi shqiptura dhjetë (10) gjoba duke arritur të mbledhim të hyra në vlerë **710.00 €**

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE EMERGJENCA

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencia promovon dhe zbaton politikat e përgjithshme të shërbimeve publike dhe kryen koordinimin e aktiviteteve të tjera ditore, javore dhe mujore.

Vizioni:

Ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët e Komunës në baza ditore, javore dhe mujore.

Prioritet për vitin 2018

- Prioriteti- 1. Ofrimi i shërbimeve komunale sa më cilësore për qytetarët e komunës.
- Prioriteti- 2. Përmisimi dhe sanimi i ndriçimit Publike në qytet dhe lagje.
- Prioriteti- 3. Trajtimi i ujërave të zeza fekale dhe atmosferike nëpër fshatra.
- Prioriteti- 4. Trajtimi i ujërave të zeza-urbane.
- Prioriteti- 5. Trajtimi i hapësirave publike në qytet.
- Prioriteti- 6. Ofrimi i shërbimeve publike sa më cilësore.
- Prioriteti -7. Rregullimi dhe caktimi i lokacionit për taksit në komunën tonë.
- Prioriteti- 8. Investime publike në rrejte të energjisë dhe ujësjellës.

Aktivitetet për vitin 2018

- Menaxhimi i situatave emergjente.
- Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE).
- Përgatitja e stafit dhe dokumenteve bazë për fatkeqësi natyrore dhe rreziqe tjera.
- Mirëmbajtja dhe deblokimi i kanalizimeve.
- Mirëmbajtja e ndriçimit Publik.
- Sinjalizimi horizontal dhe vertikal.
- Shtrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të -IV.
- Shërbimin e sigurimit të objektit të Kuvendit Komunal.

Aktivitet tjera të DSHPE

Gjate kësaj periudhe një vjeçare kemi pasur vazhdimisht të reshura të shiut, kështu që jemi ballafaquar si në vitin e kaluar me vërshime por për fat të mire pa pasoja në ekonomi familjare dhe biznese.

DSHPE në mënyre intensive është marre me mirëmbajtjen e rrugëve dhe pastrimin e borës sipas kushteve atmosferike (me kompaninë e kontraktuar) me të vetmin qëllim të sigurohet një qarkullim i lirë dhe pa pengesa për qytetaret tanë, të gjitha rrugët kanë qenë të kalueshme përfshirë edhe ato në zonat rurale.

-Kemi pranuar 366, kërkesa të ndryshme, ku janë shqyrtuar të gjitha, të miratuara 311, të refuzuar 55. Duke u bazuar në Kushtet Ndërtimore nga DPUPK-Obiliq janë lëshuar 107, Pëlqime-parimore për kyçe në rrjetin e ujësjellësit dhe në rrjetin elektrik të qytetit.

-Deri me tani kemi trajtuar (rinovuar) 131, raste të intervenimit në deblokim të rrjetit të kanalizimit nëpër qytet dhe fshatra të territorit të komunës sonë me KUR-Prishtina, njësi në Obiliq.

-Në bashkëpunim me KUR-Prishtina njësia në Obiliq kemi shtrirë rrjete të ri të ujësjellësit në këto lokacione:

- Plemetinë rruga Sokoli janë shtrire 400 m rrjet të ri të ujësjellësit.
- Shabaj rruga Atlantiku janë shtrire 300 m rrjet të ri të ujësjellësit.
- Obiliq i vjetër janë shtrirë 180 m rrjete të ri të ujësjellësit.
- Milloshevë rruga Avni Rrustemi janë shtrire 280 m rrjet të ri të ujësjellësit.

-DSHPE në vazhdimësi është marr me renovimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik, shesheve dhe objekteve komunale përmes operatorit ekonomit OE, të kontraktuar nga Komuna.

-Nga muaji Janar/2018, është themeluar ekipi për planifikim të ushtrimit të KFOR-it, "Shpata e Argjend 18-1,5" në bashkëpunim me KFOR-in, Eulex-in, AME-në, Policin e Kosovës, QKMF - Obiliq dhe zjarrfikësit -Prishtinë me qëllim të mbështeten objektivat strategjike, operacionale dhe taktike të NATO-së në Kosovë. Ushtrimi fushorë është zhvilluar në kampin – Pomozotin nga dt.23-27, prill 2018.

-Janë inspektuar aparatet kundër zjarrit në shkolla, QKMF, QPS, Çerdhe, Komunë, Palestrën sportive, dhe në automjet zyrtare, ku është në proces përgatitja e projekti për "Servisim të Aparateve kundër zjarrit".

-Në rrugën Rajonale në fshatin Sibovcë kemi pasur rrëshqitje të dheut, DSHPE me kohë ka vendosur shiritin sinjalizues dhe ka sanuar gjendjen e rrugës. Gjithashtu rrëshqitje të dheut kemi pasur edhe në hyrje të fshatit Palaj në kanal in ku bëhet shkarkimi i ujit me pompa nga mihja e KEK-ut, me kohë kemi njoftuar KEK-un.

Projekti: "Shtrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të rendit të IV-me zhavorr", jemi trajtuar rrugët me zhavorr në Mazgit, Millosheve, Lazarevë, Raskovë Breznicë, etj..

Projekti: "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe mirëmbajtja"-furnizimi me tabela, vendkalimi i këmbësoreve (zebrat), vendosja e pengesave në rruge (policë të shtrirë) dhe punimi i vijave është përfunduar.

Projekti: "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit", është përfunduar ku janë vendosur 25 stacione në vendndalime të Autobusëve si në: Obiliq, Lazarevë, Milloshevë, Breznicë, Kozaricë, Raskovë, Palaj, Babimoc, Dardhishtë, Lajthishtë, Sibovcë është përfunduar.

Projekti: "Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në Obiliq" është lidhur kontrata dhe një pjesë e këtij projekti mbetet të përfundoj në vitin 2019.

Projekti: "Furnizimi me aparate të zjarrit dhe mbushja e tyre" përmes këtij projekti është bërë furnizimi me aparate të reja dhe mbushja e tyre për shuarjen e zjarrit në Institucione komunale si: -Institucione Arsimore -Institucione Shëndetësore -Institucione Sociale (Shtëpia e Pensionistëve) QPS, dhe automjeteve zyrtare.

-Në kuadër të drejtorisë është përgatitur “Rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare në komunën e Obiliqit” e cila është miratuar nga kuvendi komunal.

-Në bashkëpunim me agjensionin për efikasitet të energjisë në kuadër të MZHE dhe në mbështetje të zyrës së BE-së është duke u përgatitur ” Plani Komunal i Veprimit për Efikasitet të Energjisë”.

Këtë vit kemi pas dymbëdhjetë raste zjarri në territorin e komunës sonë:

Rastet e zjarreve gjatë vitit 2018				
Nr.	Vendi	Data	Pronësia	Dëmet
1.	Plemetin	21.03.018	Private	Shtëpi
2.	Lajthishtë	07.04.018	Private	Shtëpi
3.	Mazgit i Epërm	09.04.018	Private	Makineri bujqësore,pjesë për vetura
4.	Plemetin	13.07.018	Private	Shtëpi
5.	Obiliq	11.08.018	Private	Mallra ushqimore
6.	Llazarevë	16.08.018	Private	Lëndë për prodhimin e orendive
7.	Milloshëvë	17.09.018	Private	Zjarr fushor-djegje e barishtave
8.	Bajmofc,Obiliq	25.09.018	Private	Zjarr fushor-djegje e barishtave
9.	Kozaricë	28.09.018	Private	Zjarr fushor-djegje e pemishtes
10.	Hade	02.11.018	Private	Shtëpi
11.	Obiliq TC KOSOVA A	03.11.018	Shoqërore	Zjarr fushor-djegje e barishtave dhe gomave të vjetra
12.	Obiliq	04.11.018	Private	Zjarr fushor-djegje e pemishtes

-Nga lëmia e mbrojtjes së zjarrit dhe siguri sipas planit vjetor të punës janë inspektuar

Inspektime nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri për vitin 2018			
Nr	Fillestare	Të rregullta	Verifikuese
1.	1	8	7
2.	Gjithsejtë inspektime: 16		

Raporti i trajtimit të rrugëve me zhavorr

Në këtë specifikim përfshihet rrafshimi me greder, furnizimi me zhavorr, shtrirja dhe ngjeshja

Nr.	Lokacioni	Sasia m ³	Fraksioni	Gjerësia	Gjatësia
1.	Mazgit -Selman Kadria	80m ³ 80m ³	0-31 0-60	4 m	248 m
2.	Mazgit – Kastriot	56m ³ 10m ³	0-60 0-31	4m	80m
3.	Mazgit-Varrezat	36m ³	0-60	4m	82m
4.	Mazgit-te familja	36m ³	0-31	4m	20m

	Binaku				
5.	Mazgit te familja Berisha	70m ³ 45m ³	0-60 0-31	4m	191m
6.	Mazgit-te familja Sollova	36m ³	0-31	4m	70m
7.	Fshati Mazgit segmenti 1 qe lidhet me Rr."Dita e Flamurit"	80m ³	0-31	4m	130m
8.	Rr."Ali Podrimja" Mazgit me nje segment	120m ³	0-31	4m	200m
9.	Rr. "Gollaku" Mazgit	20m ³	0-31	4m	50m
10.	Mazgit segmenti 2 qe lidhet me Rr."Dita e Flamurit"	60m ³ 86m ³	0-31 0-200	4m	150m+ 120m ²
11.	Llazarev Rr. "Radashevcii"	60m ³ 20m ³	0-60 0-31	4m	105m
12.	Llazarev Rr. "Te Familja Berisha"	40m ³ 10m ³	0-60 0-31	4m	40m
13.	Milloseve Rr."Te familja Hasani"	100m ³	0-31	4m	170m
14.	Milloseve Rr."Shkodra"	200m ³	0-60	4m	300m
15.	Raskove Rr."Te familja Gashi"	100m ³	0-31	4m	130m
16.	Raskove Rr."Te familja Jerliu"	96m ³	0-31	4m	120m
17.	Raskove segment qe lidhet te Rr."Zahir Pajaziti"	40m ³	0-31	4m	60m
18.	Breznice Rr."Rudinat" Llogariten edhe shkurtesat para shpiav	2.240m ³	0-60	4m	2600m
19.	Breznice Rr."Te Gradict"	40m ³	0-60	4m	80m
20.	Breznice Rr."Shahiqi"	220m ³	0-31	4m	500m
21.	Breznice segmenti qe e lidh Rr."Hoxhe Breznica"	90m ³	0-60	4m	150m
22.	Breznice Rr."Te Familja Zeka"	60m ³	0-60	4m	80m
23.	Breznice segment 2 Rr."Hoxhe Breznica"	50m ³ 70m ³	0-60 0-30	4m	160m
24.	Breznice te Vorrezat	40m ³	0-60	4m	70m
25.	Breznice te Skenderi	100m ³	0-31	4m	150m
26.	Breznice Rr."Behrami"	140m ³ 86m ³	0-60 0-100	4m	500m
27.	Plemetin Rr."Knjaz Mihajla"	100m ³	0-60	4m	150m
28.	Plemetin Rr."Sali Fikret"	200m ³	0-31	4m	250m
29.	Palaj Rr."Buna"	140m ³	0-31	4m	200m

30.	Palaj segmenti lidhes me Rr."Dibran Paloj"	200m ³	0-60	4m	300m
31.	Siboc Rr."Lluga e Kovaqit"	400m ³	0-31	4m	770m
32.	Siboc Rr."Rrezja"	200m ³	0-60	4m	400m
33.	Graboc Rr."Islam Mjeku"	500m ³	0-31	4m	900m
34.	Kryshevce Rr."Nexhmedin Shalaku"	100m ³	0-31	4m	300m
35.	Kryshevce Rr."Shaban Shalaku"	100m ³	0-31	4m	200m
36.	Obiliq Rr."Te familja Rama"	90m ³	0-31	4m	150m
37.	Segment qe e lidh Rr. "Fejzullah Grajqevci"	40m ³	0-31	4m	70m

Shpenzimet e benzinës për veturat zyrtare për vitin 2018			
Nr	Muaji	Litra	Vlera në euro
1	Janar	257.37	249.62 €
2	Shkurt	223.01	210.05 €
3	Mars	308.03	296.51 €
4	Prill	335.01	331.73 €
5	Maj	256.02	268.03 €
6	Qershor	166.84	173.20 €
7	Korrik	198.81	207.72 €
8	Gusht	156.5	163.01 €
9	Shtator	38	39.69 €
10	Tetor	219.87	229.39 €
11	Nëntor	176.85	167.26 €
12	Dhjetor	92.02	88.44 €
13	Gjithsejtë	2,428.33	2,424.65

Shpenzimet e naftës për vetura zyrtare për vitin 2018			
Nr	Muaji	Litra	Vlera në euro
1	Janar	899.37	887.41 €
2	Shkurt	781.70	746.99 €
3	Mars	1,553.60	1,495.50 €
4	Prill	1,114.79	1,121.03 €
5	Maj	1,045.60	1,112.94 €
6	Qershor	1,120.08	1,176.98 €

7	Korrik	1,392.75	1,461.97 €
8	Gusht	1,053.61	1,116.86 €
9	Shtator	1,331.55	1,441.27 €
10	Tetor	1,436.11	1,605.00 €
11	Nëntor	1,736.44	1,814.06 €
12	Dhjetor	1,465.05	1,422.56 €
13	Gjithsejtë	14,930.65	15,402.57 €

Shpenzimet e naftës për Minibusa-zyrtar për vitin 2018			
Nr	Muaji	Litra	Vlera në euro
1	Janar	542.03	534.82 €
2	Shkurt	697.02	666.07 €
3	Mars	620.02	596.83 €
4	Prill	527.27	530.22 €
5	Maj	847.04	901.59 €
6	Qershor	508.02	533.83 €
7	Korrik	136.00	142.76 €
8	Gusht		
9	Shtator	716.07	775.07 €
10	Tetor	816.02	911.98 €
11	Nëntor	920.20	961.33 €
12	Dhjetor	771.04	748.68 €
13	Gjithsejtë	7,100.73	7,303.18 €

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Raporti i Punës për vitin 2018

Drejtorja e Inspektoratit, gjatë kësaj periudhe ka punuar me plan-programin e punës për vitin 2018 duke u bazuar në kompetencat e saj të cilat janë deleguar nga Ligjet, udhëzimet administrative dhe Rregulloret Komonale. Për këtë periudhë kemi kryer punë të përditëshme që e karakterizojnë këtë drejtori.

Vërehet një ngritje e dukshme e kapaciteteve të punës në të gjitha inspektimet krahasu me vitet paraprake.

Prioritet gjat këtij viti i kemi dhënë:

- Regjistrimit të bizneseve të reja.
- Pranimit dhe kërkesave të qytetarëve .
- Inspektimit në fushën e ndërtimeve.

- Inspektimeve në komunikacionin rrugor.
- Inspektimeve në sanitari .
- Inspektimeve në tregëti etj.

Raporti i punës së Drejtoris së Inspektoratit është i pregatitur për secilin inspektor veç e veç në formë tabelare por është i përmbledhur edhe në një tabelë. Ndërsa në fund të raportit janë të pasqyruara në formë tabelare dhe me përshkrim për secilin inspekti të bërë me proces.

RAPRTI I PËRGJISHËM I PUNËS NJË VJEÇAR NË FORMË TABELARE

Numri i inspektimeve me Procesverbal	849
Numri i kërkesave nga palët	137
Numri i ftesave për palët	56
Inspektim i përbashkët me Policinë	16
Kërkesë për Gjykatë	10
Inspektim me Inspektor të nivelit qendror	7
Gjoha mandatore	41
aktvendime	74
Pelqime për plotësimin e kushteve higjieno sanitare	96
Numri I kërkesave nga qytetarët për drejtorin	137
Të miratuara (kërkesë)	106
Të refuzuara (kërkesë)	6
Të hedhura poshtë(kërkesë)	2
Të pezulluara (kërkesë)	1
Të anuluar (kërkesë)	2
Të ceduar(kërkesë)	20

Nr.	Raporti i punës i Inspektorit te tregut për vitin-2018	Gjithësejt	Vërejtje
1	Numri i Inspektimeve të përgjithëshme	629	

2	Inspektime me proqesverbal	256	
3	Numri i Inspektimeve të lokaleve ushqimore dhe tregtare	89	
4	Numri i Inspektimeve të lokaleve hoteliere	88	
5	Numri i Inspektimeve pompave te benzines	8	
6	Numri i Inspektimeve të Barnatoreve	15	
7	Numri i Inspektimeve të tjera	13	
8	Inspektimi i perbashkët me Inspektoret shtetror	5	
9	Inspektimi i perbashkët me Policin e Kosovës	3	
10	Fletëparaqitje për Gjykatë	/	
11	Gjoha mandatore	6	1015€
12	Numri i kërkesave nga palet	106	
13	Pranime me komision	96	96x45=4320€
14	Inspektime në shoqerim me inspektorët e tjerë	365	
15	Numri I inspektimeve te Ordinancave	9	
16	Inspektime në SalloneOndulimi	25	
17	Inspektim në fabriken për perpunimin e mishit	2	
18	Asgjasim të mallit	3	3x20=60€
19	Ftesa për pal	5	

Gjatë kësaj periudhe kohore të inspektimit si prioritet kemi pasur:

- Regjistrimin e bizneseve të reja
- Vendorsjen e çmimeve dhe të orarit të punës
- Kontrollimin e dhënies së faturave shitëse ,blerësve-konsumatoreve
- Kontrollimin e deklaracionit të mallit-kualitetin,shërbimet
- Kontrollimi I te gjitha subjekteve afariste qe bëjnë transportimin e mallrave nga subjekti te subjekti tjetër, kontrollimi I dokumentacionit përcjellës,
- Inspektimi I kushteve teknike te subjekteve afariste tregtare që merren me shumicë dhe pakice dhe subjektet shërbyese etj
- Kontrollimi I peshojave (kalibrimi I tyre)
- Bashkëpunimi me inspektoratet qendror edhe ndërkomunale si dhe me Policin e Kosovës

- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave eventuale

Nr.	Raporti i punës i inspektorit Sanitar për vitin 2018	Gjithsej	Emri Palës
1	Inspektime të përgjithshme	604	
2	Inspektime me procesverbal	306	
3	Inspektime në lokale ushqimore	90	
4	Inspektime në lokale hoteliere	89	
5	Inspektime në barnatore	15	
6	Thirrje për palë	1	
7	Gjoha mandatorë	17	
8	Të proceduara për Gjykatë	1	
9	Fabrika për prodhimin e produkteve	9	
10	Aktvendime	9	
11	Numri i kërkesave nga palët	5	
12	Inspektime në furra	21	
13	Inspektime në Shkolla	21	
14	Inspektime në Sallone Ondulimi	25	
15	Inspektime në Pishina	3	
16	Asgjësimit të mallit një me kërkesë	9	
17	Inspektime Komunale	4	
18	Inspektim në Ambolanta	9	
19	Inspektime në Çerdhe	4	
20	Inspektim në lojëra rekreative	2	
21	Inspektime në Lëmi tjera	10	
22	Inspektime- Pranime me komision	96	
23	Inspektim në shoqërim me Inspektorët tjerë	202	
24	Inspektime në Barnatore Bujqësore	4	

Inspektori Sanitar Sipas planit të punës gjatë këtij viti prioritet kemi pas kontrollin e kualitetit të ushqimit, kushteve higjienike-sanitare të objekteve që zhvillojnë veprimtari tregtare, hoteliere, zejtare pastaj, objekteve për mirëmbajtje të higjienës personale, objekteve publike. Në mënyrë Permanente është bërë inspektimi i artikujve ushqimor me pakicë dhe shumicë si në objekte ashtu edhe jashtë tyre, kontrolli i kushteve higjienike-sanitare, asgjësimin e mallit kur është në pyetje afati i përdorimit, ndalimi i ekspozimit të artikujve ushqimor për shkak të faktorëve të jashtëm natyrorë, kontrollin për librezë sanitare, kontrollin për konsumimin e duhanit në vende publike.

Masat e marra gjatë kësaj periudhe kemi pasur 9. raste të asgjësimit të mallit, një ka qenë me kërkesë nga pala 8. Gjoha mandatore, 1. Lëndë të proceduar për Gjykatë, 9. Aktvendime si dhe vërejtje të dhëna me gojë dhe me shkrim aty ku e kemi pa të nevojshme. Me këto masa të marra kemi arrit që ti vedisojmë bizneset në një mas të madhe. Këtë mese miri e vërteton vetë fakti që është zvogëluar numri i ankesave nga qytetarët.

Nr.	Raporti i punës i inspektorit të Komunikacionit për vitin 2018	Gjithsej	Emri Palës
1	Inspektime të përgjithshme	126	
2	Inspektime me procesverbal	126	
3	Gjoha mandatorë	9	
4	Të proceduara për Gjykatë	6	
5	Aktvendime	15	
6	Kërksa nga palët	3	
7	Inspektime me Policinë	10	
6	Inspektim në shoqërim me Inspektorët tjerë	75	

Inspektori Komunikacionit Sipas planit të punës, gjatë këtij viti prioritet kemi pas kontrollin e Operatorëve të udhëtarëve, gjegjësisht Kontrollin e dokumentacioneve dhe Rend udhëtimet.

Masat e marra gjatë kësaj periudhe kemi shqiptuar, (9) Gjoha mandatore, (6) Lëndë të proceduara për Gjykatë, (15) Aktvendime si dhe vërejtje të dhëna me gojë dhe me shkrim aty ku e kemi pa të nevojshme.

RAPORT- nga: Inspektorët e Ndërtimit, Ibrahim Krasniqi, Ramadan Hashani

Nr.	RAPORTI VJETOR - 2018	Gjithsejt
1	Numri i inspektimeve të objekteve me leje ndërtimi	65
2	Numri i inspektimeve të objekteve pa leje ndërtimi	48
3	Numri i Rrethimit të objekteve	15
4	Numri i inspektimeve për rrënim të objekteve me leje	2
5	Numri i inspektimeve të objekteve me kushte ndërt.	6
6	Numri i kërkesave nga palët	6
7	Inspektimet me proqesverbal	161
8	Inspektimi i përbashkët me inspektor	460
9	Inspektimi i përbashkët me inspektorët e MMPH-së	2
10	Inspektimi i përbashkët me policinë e Kosovës	3
11	Inspektime jashtë sektorit të ndërtimit	37
12	Fletëparaqitje për Gjykatë	3
13	Gjoha mandatore	9
14	Aktvendime për ndërprerje	39
15	Aktvendime për rrënim	5
16	Vërejtje	30
17	Puna në komision për pranime teknike dhe kushte sanitare-teknike	83
18	Ftesa për palë	41

PËRFUNDIM:

Bazuar në gjendjen aktuale në Territorin e Komunës së Obiliqit, konkretisht ndarjen e zonave me interes të veçantë të shfrytëzimit të tokave dhe mundësitë e qytetarve për nevoja në ndërtim, konsiderojmë se është e nevojshme një çasje direkte rreth një zgjidhjeje në këtë sektor.

Mendoj që gjendjen e ka vështirësuar edhe dështimi i Ligjit Nr.04/L-188, për trajtimin e ndërtimeve pa leje, ku sipas disa statistikave ka dështuar tërësisht ky proces dhe pritjet e një Draft-Ligji tjetër për legalizim të objekteve ndërtimore.

Për dallim nga gjashtëmujori i parë, gjatë këtij gjashtëmujori (të dytë) kemi qenë më të angazhuar me inspektime në Zonën e Interesit të Veçantë Ekonomik (ZIVE), ku kemi bërë inspektime rutinore të përditshme në mënyrë që ta evitojmë intensitetin e ndërtimeve që ka ndodhur më herët. Potencialisht edhe gjatë kësaj periudhe kohore nga dt. 01.07.2018 e deri më 31.12.2018 kemi kryer inspektime rreth ndërtimeve të objekteve të ndryshme dhe në fokus kemi pasur mënyrën e vetëdijesimit të qytetarëve rreth procedurave për t'u pajisur me leje ndërtimore në mënyrë që të evitohen parregullsitë në aspektin Urbanistik .

Po ashtu kemi marrë masa në disa raste ku kemi hasur në persona të pa ndërgjegjshëm në aspektin e mosperfilljes së urdhërësive që i parasheh Ligji i Ndërtimit Nr. 04/L-110, si dhe U.A., që dalin nga ky ligj në fuqi, ku është paraqitur nevoja për ndëshkime me gjoha mandatore.

Andaj në bazë të përkushtimit dhe performancës në këtë drejtim, mund të konkludojmë se kemi arritur rezultate, edhe pse jo sipas pritjeve të dëshiruara për tu arritur objektivat e punës tonë.

DREJTORIA PËR KULTURË RINI DHE SPORTË

Raporti i Punës për vitin 2018

Manifestimet dhe aktivitetet Kulturore Sportive dhe Rinore që janë realizuar nga DKRS-ja gjatë këtij viti.

- Plani i punës së DKRS
- Shqyrtimi i kërkesave
- Kontratat për material sportiv dhe furnizim me lule
- Projektet për lapidarët dhe përmendoret
- Përgatitjet për 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës me Këshillin Organizativ
- Me rastin e krenimit të 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës u shënuan për 10 ditë radhazi aktivitet të ndryshme:
 1. Aktivitete sportive – Ping -Pong me Shoqatën e Pedagogëve dhe shkollat
 2. Debat me nxënësit e shkollave të mesme dhe me kryetarin
 3. Aktivitete rinore - DKRS, Qendra Rinore me grupe rinore
 4. Ligjëratë me QKMF, tema „Edukimi seksual”
 5. Aktivitete sportive- DKRS në bashkëpunim me shkollën e mesme teknike “Ismajl Dumoshi” , Turnir në futboll
 6. Aktivitete sportive- turnir në basketboll me gjeneratat e reja
 7. Aktivitete sportive – Skijim në Brezovicë
 8. Ndashje miqësore për nder të Pavarësisë nga Shoqata e Veteranëve të Futbollit
 9. Aktivitete kulturore - Shfmu”Naim Frashëri” Breznicë
 10. Koncert: Ansamblet e qytetit
 11. Manifestimi qendror
- Përgatitja e projekteve për MKRS,
- Projektet për fushat sportive
- Java e Bibliotekës
- Marrëveshje me Qendrën Rinore për avokimin e të rinjve për punë vullnetare në institucionet publike
- Komision për regjistrimin dhe vlerësimin e inventarit në komunën e vjetër
- Takim me Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Shpallja Publike për ndarjen e subvencioneve për Kulturë, Rini dhe Sport
- 5 Maji Dita e Dëshmorëve
- 1 Qershori Dita Ndërkombëtare e fëmijëve
- 14 Qershori muaji i Krenarisë
 - 1.Ekspozitë
 - 2.Seminare
 3. Aktivitet Rinore, Ping- pong, Shah,Pikado
- Gara këndim “Edhe unë kam talent”
- Ditët e mërgimtarëve
- Festivali „Ndriço Fest”

- Promovovimi i sportit në komunën tonë në bashkëpunim me MKRS-në
- Java Rinore
 1. Turnir në futcall
 2. Aktivitet sportiv Streetboll
 3. Gara në volejball
 4. Gara në futboll te vogël
 5. Ekspozita “Fotografia nga sytë e mi”
 6. Ligjerata për paragliding
 7. Festivali, „Green Art Fest”
- Krosi Vjeshtor
- 28 Nëntori
- Zbulimi i lapidarit të dëshmorëve në Hade të Re
- Shpallja e Sportistit të Vitit
- Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit

Investimet kapitale në DKRS-së

Ndërtimi i lapidarëve dhe permendoreve dhe mirëmbajtja
 Lapidari në Hade te Re
 Lapidari në Hmidi
 Lapidari në Siboc
 Lapidari Fahri Fazliu
 Lapidari Abdurrahmon Gërguri
 Lapidari te familja Halimi
 Lapidari Isuf Shalaku

Rregullimi i fushave sportive

Fusha e sportit në fshatin Milloshevë afër Xhamisë
 Fusha e sportit në fshatinë Dardhishtë
 Fusha e sportit në shkollën fillore Ibrahim Rugova.

DREJTORIA E BUJQËSIS DHE ZHVILLIMIT RURAL

Raporti i Punës për vitin 2018

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, duke u mbështetur në kompetencat të cilat derivojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale, e ngarkuar me punët nga statuti i Komunës ka realizuar me përpikri detyrat e hartuara për vitin 2018. Duke i dhënë prioritet zhvillimit të bujqësisë, mbështetja ka filluar me përkrahjen e ekonomive të vogla familjare bujqësore, dhe rritjen e interesimit të qytetarëve për qasje me konstruktive në këtë lëmi.

AKTIVITETET E PUNËS

Bujqësia në komunën e Obiliqit është një sektor i rëndësishëm dhe me potencial për zhvillimin ekonomik, për këtë arsye kemi vendosur mbështetje në vazhdimës të fermerve me projektet si:

- “Ngritja e serave tunel 50 m² për perim-kulturë”.
- ” Motokultivator me retrofrezë”.
- “ Makina mjelëse për blegtorë ”.
- “ Inkubator për shpeztari ”
- “ Sistem pikë pikë ” për perimtari.
- “ Dhi qumështore “.
- Vaksionimi i Bagëtime
- Perkohje me nga Dy Familje Bletë
- Ushqim për Bletë
- Subvencionim me Far Gruri dhe naftë
- Ngritja e serave tunel faza e dytë
- Subvencionim sipas kërkesave të fermerve.

□Drejtorja për Bujqësi gjatë kësaj periudhe ka bërë vazhdimisht monitorimin e pyjeve të komunës.Drejtorja e Bujqësis ka organizuar (18) trajnime dhe këshilla nga stafi i qertefikuar me fermerët në koordinim me MBZHR. Ndërsa gjatë këtij viti kemi pasur një kërkes për prerje të pyjeve private e cila është bartur në Agjencionin e Pyjeve të Kosovës.

Në tabelë është paraqitur ndarja e subvencioneve për vitin 2018

Emërimi i projekteve për subvencionim	Shuma e subvencioneve
Projekti - “Ngritja e serave tunel 50 m ² për perim-kulturë”.	23,400.00€
Projekti- ” Motokultivator me retrofrezë”.	14,800.00€
Projekti-“ Makina mjelëse për blegtorë ”.	3,900.00€
Projekt - “ Inkubator për shpeztari ”	2,000.00 €
Projekti-“ Sistem pikë pikë ” për perimtari.	3,100.00€
Projekti-“ Dhi qumështore “.	4,250.00€
Projekti -Vaksinimi i kafshëve kundër sëmundjeve të klostridieve dhe fasciolave	10,000.00€
Projekti-Perkohja me Dy familje Bletë	6.840.00

Projekti-Ngritja e serave faza e dytë	27.884.00
Projekti-Subvencionim me Farë Gruri dhe Naftë	15.930.00
Projekti-Subven.Fermervë me Kërkesa	2.100.00
Projekti-Ushqim për Bletë	6.640.00
Totali	120.844.00

	Projektet	Komuna	Bashkëfinancim	Shuma Totale	Përfitues	Mjetet e shpenzuara nga linja
1	Ngritja e serave	18,720.00	4,680.00	23,400.00	60	Bashkëfinancim
2	Motokultivatr me retrofrezë	11,860.00	2,960.00	14,800.00	40	Bashkëfinancim
3	Makinamjelëse për blegtorë	3,120.00	780.00	3,900.00	20	Bashkëfinancim
4	Inkubator për shpeztari	1,600.00	400.00	2,000.00	20	Bashkëfinanci
5	Ngritja e serave faza dytë	22,284.00	5.600.00	27.884.00	80	Bashkëfinancim
Total		57,564.00	14,420.00	71,984.00	220	

Në Drejtorin e Bujqësisë ka pasur tri kërkesa për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore të cilat janë përcjell në MBPZHR-së , kurse një kërkesë për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë jo bujqësore është refuzuar.

Numri i kërkesave të përaqitura në DBZHR-së.

Nr. i kërkesave	Kërkesat nga qytetarët		
	Miratuar	Refuzuara	Në proces
265	245	11	9

Numri i fermerëve që kanë aplikuar për subvencione në veprimtari të ndryshme përmes DBZHR-së në Ministrin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit janë paraqitur në tabelë.

Numri i fermerëve	Grurë	Misër	Patate	Pemëtarë	Lopë	Dele	Bletë	Perime
439	996.95 ha	461 ha	36.01 ha	33.6 ha	735	791	2992	53 ha

Numri i fermerëve	Elb
11	31.6 ha

Numri i fermerëve	Fasule
14	3.71 ha

- Aplikuesit të subvencionimit për cilësi të qumështit për nëntë mujë kanë aplikuar në DBZHR-së janë (14) (katërmëdhjet).
- Sasia e qumështit për subvencionim është 527.066.00 litra nga MBPZHR për 14 fermer.

PROJEKTET E IMPLEMENTUARA:

1. Projekti - Ngritja e serave tunel 50 m² për perim-kulturë:

Ftesa publike është bërë me datën 15.02.2018 dhe ka përfunduar me datën 02.03.2018. Nga numri i përgjithshëm i aplikusve në këtë projekt prej 181, përfitues janë (60) aplikues.

2. Projekti- Motokultivator me retrofrezë:

Ftesa publike është bërë me datën 15.02.2018 dhe ka përfunduar me datën 02.03.2018. Nga numri i përgjithshëm i aplikusve në këtë projekt prej (122), përfitues janë (40) aplikues.

3. Projekti - Makina mjelëse:

Ftesa publike është bërë me datën 15.02.2018 dhe ka përfunduar me datën 02.03.2018. Nga numri i përgjithshëm i aplikusve në këtë projekt prej (43), përfitues janë (20) aplikues.

4. Projekti - Inkubator për shpeztari:

Ftesa publike është bërë me datën 15.02.2018 dhe ka përfunduar me datën 02.03.2018. Nga numri i përgjithshëm i aplikusve në këtë projekt prej (47), përfitues janë (20) aplikues.

5. Projekti - Sistem pikë pikë

Ftesa publike është bërë me datën 15.05.2018 dhe ka përfunduar me datën 31.06.2018. Nga numri i përgjithshëm i aplikusve në këtë projekt prej (45), përfitues janë (31) aplikues.

Kërkesa për ndarjen e mjeteve është bërë pasi fermerët kanë dorëzuar faturën e rregullt të bashkangjitur me kupon fiskal.

6. Projekti - Dhi qumështore

Ftesa publike është bërë me datën 15.05.2018 dhe ka përfunduar me datën 01.06.2018.

Nga numri i përgjithshëm i aplikusve në këtë projekt prej (21), përfitues janë (17) aplikues.

Përfituesit e projekteve 1,2,3 dhe 4 kanë participuar me 20%.

7.Projekti i vaksinimit te Deleve, Dhive dhe Lopëve

Projekti ka filluar me 20.08.2018 dhe ka përfunduar me 10.09.2018.

Janë vaksinuar 4000 cop Dele,Dhi si dhe Lopë.

7. Projekti per përkrahjen e bletarve te rinjë

Projekti ka filluar shpallur 04.06.2018 dhe ka përfunduar 04.07.2018.dhe kanë përfituar 34 bletar te rinjë me nga dy familje bletë.

9.Projekti serave pjesa e dytë:

është shpallur 03.09.2018 dhe ka përfunduar 15.10.2018 ndersa montimi ka filluar 03.11.2018

dhe montimi i konstruksionit ka përfunduar me 23.11.2018.Perfitues janë 80 fermer.

Ndersa folija e plastikës ka mbetur pa përfunduar pershkak te temperaturave te ulta .

10.Projekti Subvencionim me farë gruri dhe naftë:

është shpallur 15.09.2018 dhe ka përfunduar 09.10.2018 përfitues janë 118 fermer.

11.Projekti Subvencionim me ushqim për Bletë:

është shpallur 15.09.2018 dhe ka përfunduar 05.11.2018 përfitues janë 61 fermer.

12. Kemi pas edhe tri kërkesa për subvencione të tre fermeret të cilët janë përkrah.

ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Raporti i Punës për vitin 2018

Zyra për komunitete dhe kthim e Komunës së Obiliqit është pjesë e Administratës Komunale dhe ka dy shërbime në përbërjen e saj:

1. Shërbimin për kthim në të cilin janë të punësuar një kordinator dhe tre zyrtarë.
2. Shërbimin për rintegrim, ku janë të punësuar një kordinator dhe tre zyrtarë. Së bashku me udhëheqësin e Zyrës Lokale për Kthim dhe Komunitete kjo Zyre ka të punësuar (9) shërbyes civilë.

SHËRBIMI PËR KTHIM:

Sa i përket raportit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe kthim të Komunës së Obiliqit, gjatë vitit 2018, kjo Zyre ka vazhduar punën me programin RRK-5, ku nga 11 komuna të përfshira në këtë projekt është edhe Komuna Obiliqit. Në fazën e parë prej 42 shfrytëzuesve janë miratuar 15 shfrytëzues, ndërsa të tjerët janë në pritje, por në grupin qendror të punës është kërkuar verifikimi për tre shfrytëzues, ndërsa për 12 të tjerët mund të fillojnë punimet. Për mungesë të kohës, përfaqësuesit e IOM-it kanë deklaruar se nuk mund të fillojnë punimet përnjëherë, ndërsa 6 shtëpi do të ndërtohen vitin e ardhshëm. Për 6 familjet të cilave u janë përfunduar objektet dhe janë pranuar teknikisht u është shpërndarë asistencë tjetër e paraparë si në vijim: pakot e mobiljeve, teknika e bardhë, ushqimi, pajisjet higjienike, drutë, ndërsa projekti për gjenerimin e të hyrave për kthim të qëndrueshëm ende nuk është miratuar.

Zyra për Komunitete në muajin prill ka mbajtur një mbledhje me grupin të punës, ku janë shqyrtuar 27 raste të familjeve për kthim. Derisa në muajin maj edhe dy mbledhje të grupit të punës, me ç'rast kanë arritur kërkesat nga ana e UNHCR-it, rastet e shfrytëzuesve janë përpunuar dhe janë vizituar në terren dhe nga numri i përgjithshëm prej 62 dhe plus 37 familjeve që i ka kthyer UNHCR-i u janë dhënë ndihmat që u takojnë duke përfshirë edhe pagimin e qiras për banim. Për këto familje kemi organizuar shumë takime gjatë vitit 2018 nga vetë udhëheqësit komunal së bashku me përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe po përpiqemi t'u ndihmojmë sa kemi mundësi, por kanë edhe shfrytëzuesit tjerë të komunave dhe duhet dhënë prioritet të tjerëve. Po ashtu janë përpunuar rastet e 15 familjeve që evidentohen si të shpërngulura interne. Në bazë të kriterëve, familjet që i plotësojnë kushtet për kthim kanë hyrë në procedurë të rregullt dhe do të shqyrtohen gjatë zbatimit të projektit. Në proces i kemi përpunuar 12 raste të familjeve që jetojnë në baraka prej viti 1999 dhe për çka jemi të obliguar ta mbyllim kampin e që jemi afër për ta bërë pranë stadiumit në Plemetin, ku na kanë mbetur edhe dy familje.

Aktiviteti tjetër ri rregullt të ZKKK gjatë kësaj periudhe të raportimit ka qenë edhe regjistrimi i familjeve të kthyera që janë vendosur në shtëpitë e tyre të sapondërtuara në Komunën e Obiliqit. Ky proces është kryer në bashkëpunim të ngushtë me UNHCR, si partner zbatues me organizatën joqeveritare „Advancing Together“ (AT).

Regjistrimi i familjeve të kthyera	Serbe	Rome	Ashkali	Egjiptase	Boshnjake	Gjithsej
Gjithsej familje	21	16	4	///	1	42

Përveç kësaj,shërbimi i ZKKK-së përgjegjës për procesin e kthimit në Komunën e Obiliqit ka kryer vlerësimin e rregullt gjashtëmuor të integrimit të të gjitha familjeve të kthyer në bashkëpunim me UNHCR si partner zbatues me oprganizatën joqeveritare „Advancing Together“ (AT). (Tabela e mëposhtme).

Vlerësimi vjetor I integrimit të familjeve	Serbe	Rome	Ashkali	Egjiptase	Boshnjake	Gjithsej
Gjithsej familje	3	2	///	///	1	6

Përmbledhje

Ky raport vjetor i punës për vitin 2018 shfaqë përmirësimin dhe efikasitetin në punën e ZKK-së në Komunën e Obiliqit gjë që tregojnë rezultatet e arritura në bazë të aktiviteteve të planifikuara.Vlen të përmendim sa u përket famljeve të zhvendosura në vendet e regjionit dhe atyre përbrenda Kosovës, kanë shfaqur interesim për kthim dhe gjetje të zgjidhjes së përhershme të familjeve të tyre. Komuna e Obiliqit gjatë punës në vitin 2018 sipas të gjithë treguesve ka qenë drejtuese e vërtetë e një numri të caktuar të familjeve të zhvendosura jo vetëm të atyre me prejardhje nga komuna, por edhe e atyre jashtë saj të cilat shohin perspektivë dhe zgjidhje të përhershme në këtë mjedis.

Me gjithë resurset e kufizuara dhe të mjeteve, Komuna jonë (në kuadër të saj edhe ZKKK) në mënyrë profesionale ka shqyrtuar të gjitha rastet e familjeve dhe në bazë të Ministrisë për Kthim dhe Komunitete.”Udhëzimet për zbatimin e përkrahjes për kthim” dhe Ndihma në banim për kthim të refugjatëve të zhvendosurve përbrenda Kosovës së bashku me të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces, ka arritur që gjatë kësaj periudhe të raportimit të marrë vendime për çdo familje individualisht për asistencën e paraparë.

Shërbimi për reintegrim:

Personat e riadhesuar që janë kthyer dhe paraqitur përmes Zyrës në vitin 2018 kanë qenë afërsisht 50 familje (nga 50 familje, 25 janë familjare ndërsa 25 të tjerë të vetëm).Këto familje kryesisht janë kthyer nga Gjermania, Belgjika, Anglia, Hungaria, Austria, Zvicra, ndërsa sipas strukturës etnike janë shqiptarë, Romë,Ashkali,Egjiptasë. Famjljet që janë kthyer dhe që posedojnë pronë personale kthehen nëpër shtëpitë e tyre, dhe për të njëjtat përkujdesemi me pako të ndryshme si u takon, derisa familjet që nuk kanë pronë, së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme u sigurojmë banim për një vit. Po ashtu u sigurojmë edhe pakot tjera të nevojshme si dhe konkurojnë për projekte të rintegritimit në vlerë prej 3.000,00€, e gjithë kjo bëhet në baza ligjore, gjegjëisht në bazë të Rregullores 13/2017. Një numër i caktuar nuk i plotëson kriteret apo është refuzuar në bazë të punës së komisionit që punon në terren.

Vlerësimi vjetor i integrimit të familjeve	Shqiptarë	Rome	Ashkali	Egjiptas	Boshnjak	Gjithsej

Gjithsej familje	39	4	5	2	///	50
------------------	----	---	---	---	-----	----

Këto familje që janë kthyer nga vendet tjera vizitohen rregullisht, po përpiqemi t'u dalim në ndihmë maksimalisht duke u nisur nga kërkesat e ndryshme që u nevojiten për konkurim në projekte e deri tek dokumentacioni personal, vërtetimet për përkujdesje shëndetësore e të tjera.

Zyra së bashku me organizatat jo-qeveritare "Voraë" me seli në Graçanicë ka punuar në rregullimin e dokumentacionit dhe ka lëshuar vërtetime për konkurrenca në bursa të fakultetit dhe për nxënësit e shkollës së mesme. Të drejtën për bursë për vitin 2018 e kanë realizuar 42 nxënës të shkollës së mesme dhe 2 studentë të Komunës së Obiliqit.

